REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

DOKUMENTAT STANDARDE
TË PROCEDURËS SË HAPUR
MALLRA [1]

Objekt: "**Ndertimi i Datacenterit Sekondar"**

[1] Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash autoriteti kontraktor do ti referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

I NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	OSHEE GROUP sh.a
Adresa	Blv "Gj.Fishta", Nd Nr. 88, H.1, Nj. Administrative Nr.7, 1023, Tiranë.
Tel/Fax	042274185 / 0694146337
E-mail	armand.guxo@oshee.al (person pergjegjes: Armand Guxo)
Faqja në Internet	www.oshee.al / prokurime@oshee.al

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion qëndror	Institucion i pavarur
☐	☐
Njesi e qeverisjes vendore	Tjetër
☐	**X**

1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po ☐ Jo **X**

Seksioni 2. Objekti i kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës: REF-89920-03-12-2021

2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Mallra"

Blerje	Qira	Leasing	Blerje me këste	Një kombinim i tyre
X	☐	☐	☐	☐

2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po ☐ Jo **X**

2. 4 Lloji i Marreveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik ☐

Me disa operatorë ekonomikë ☐

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po ☐ Jo ☐

Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloj Marrëveshje Kuadër.

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër:_____(*Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër*).

2. 6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike .	

2. 7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin kontraten: Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.,

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës: 89,815,966.67 (Tetedhjete e nente milion e tetëqind e pesembedhjete mijë e nenteqind e gjashtedhjete e gjashte pik gjashtedhjete e shtate) leke pa TVSH.

2. Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është _____**

3. Burimi i Financimit: Nga te ardhurat e veta te OSHEE GROUP sh.a

4. Objekti i kontratës: Ndertimi i Datacenterit Sekondar

2. 9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 180 (njeqind e tetedhjete) dite nga data e lidhjes se kontrates.

ose

duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

2.9.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: □□ *ose* **ditë:** □□□□ **(nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër***(jo më shumë se (4) vjet***)** *Ose* **duke filluar nga** □□/□□/□□ **(dd/mm/vvvv)** **Përfunduar më** □□/□□/□□ **(dd/mm/vvvv)**

2.10 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës/marrëveshjes kuadër: Ne ambientet e OSHEE GROUP sh.a, sipas specifikimeve teknike.

2.11 Ndarja në LOTE:

Po □ Jo **X**

Nëse po,

2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve

(Objekti dhe fondi limit i LOTEVE)
1_____
2._____
3._____
etj

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

2.13 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme *(nëse ka)*: **Ska**

Ose: nga □□ në □□

2.14 Do të pranohen variantet:

Po □ Jo **X**

2.14.1 Do të pranohet nenkontraktimi:

Po ☐ Jo **X**

Nese do te lejohet nenkontraktimi, te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim: ____

Autoriteti kontraktor do t'i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po ☐ Jo **X**

Shenime te tjera

_____
_____
_____

2.15. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqerisë së Informacionit:

Po ☐ Jo ☐

2.16. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standardet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po ☐ Jo ☐

Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimit sipas shtojcës 9.

3.2 Sigurimi i Ofertës[2]: (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 4. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është _____ Lekë (shuma e shprehur në fjalë).

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, për secilin nga Lotet është si më poshtë:

[2] Sigurimi i ofertes nuk kërkohet në procedurat e prokurimit me vlerë më të ulët se kufiri i lartë monetar

Loti 1 _____ Lekë
Loti 2 _____ Lekë

Seksioni 4 **<u>Procedura</u>**

4.1 Lloji i procedurës: E Hapur

Procedurë prokurimi e rishpallur

Po ☐ Jo **X**

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së prokurimit të anulluar _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimi të anulluar _____

c)Fondi limit i procedurës së prokurimit të anulluar _____

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **çmimi më i ulët X**

Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, **çmimi më i ulët** bazohet në:

i) çmimi i bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave;
ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
iii) marzhi më i ulët i fitimit, të shprehur në përqindje.

Vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes se çmimeve.

Ose

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme** ☐

lidhur me rëndësinë: Çmimi ☐☐ **pikë**

etj. ☐☐ **pikë**

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **08/04/2021** **Ora: 12:00**

Vendi: www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **08/04/2021** **Ora: 12:00**

Vendi: www.app.gov.al

Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150 *(Njeqind e pesedhjete) dite*

4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip **X** Anglisht ☐

Tjetër _____

Seksioni 5 Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë *(i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):*

Po ☐ Jo **X**

Nëse Po

Monedha _____ Çmimi _____

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)

_____

_____

_____

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi: **16/03/2021**

Njoftimi i kontrates për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	OSHEE Group sh.a
Adresa	Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë.
Tel/Fax	042274185
E-mail	prokurime@oshee.al (person pergjegjes: Armand Guxo, me nr.tel. 0694146337 email armand.guxo@oshee.al)
Faqja në Internet	www.oshee.al

2. Lloji i procedurës se prokurimit: "E hapur – mallra" me mjete elektronike

3. Objekti i kontratës: "Ndertimi i Datacenterit Sekondar"

4. Numri i referencës së procedurës: REF-89920-03-12-2021

5. Fondi limit: 89,815,966.67 (Tetedhjete e nente milion e tetëqind e pesembedhjete mijë e nenteqind e gjashtedhjete e gjashte pik gjashtedhjete e shtate) leke pa TVSH.

6. **Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin**: 180 (njeqind e tetedhjete) dite nga data e lidhjes se kontrates.

7- Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: data 08.04.2021 ora 12:00 ne www.app.gov.al.

8- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: data 08.04.2021 ora 12:00 ne www.app.gov.al.

II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

Seksioni 1. Hartimi i ofertës

1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.

1.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertes duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.

1.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomik, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit

1.5 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma (a) të LPP-së.

1.6 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formulari i Ofertës, plotësuar sipas Shtojcës 1 të DT ose Shtojcës 2 të DT (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje).

b) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione etj*)
_____ ,
_____ ,
_____ .

c) Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 2/1.

ç) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 8.

d) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Me plotesimin e Shtojcës "Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së Dispozitave Ligjore në Marrëdhëniet e Punës", operatori ekonomik pranon se ka kontrata pune me çdo punëmarrës dhe që respekton të drejtat e punëmarrësve, sipas dispozitave të Kodit të Punës (ku përfshihen edhe të drejtat e gruas shtatzënë, gruas që sapo ka lindur dhe/ose gruas me fëmijë në gji, të parashikuara në nenet 104, 105, 105/a, 106, 108 dhe 115, dhe të legjislacionin të punës në tërësi.

1.7 Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.

1.8 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për furnizimin e mallrave; Nr e Njoftimit _.
"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA dd/mm/vv _____ orës _____"

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

1.9 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **"MODIFIKIM OFERTE"** ose **"TËRHEQJE OFERTE".**

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund te modifikojë në çdo kohë ofertën deri përpara përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

Seksioni 2 <u>Përllogaritja e ofertës ekonomike</u>

2.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të levrohen, sasitë dhe çmimin e tyre.

2.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të ofertës të të gjitha Mallrave, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.

2.4. Në rastin e nje marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar, çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini-konkursi midis operatorëve ekonomikë, palë në marreveshjen kuadër.

2.5 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.

2.6 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare
b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet së bashku me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

2.7 **Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës**

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë nga përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshëmrinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

2.8 Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së

Seksioni 3. Vlerësimi i Ofertave
3.1 Kriteret e përzgjedhjes

(Opsioni 1) Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.

Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, **çmimi më i ulët** bazohet në:

i) çmimi i bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave;
ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
iii) marzhi më i ulët i fitimit, të shprehur në përqindje.

Vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes se çmimeve.

(Opsioni 2) Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

Po= Pk1+Pk2+Pk3+.....

Ku:
Po - jane pikët totale të ofertës së vlerësuar
Pk1/Pk2/Pk3/... - jane pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përllogariten sipas formulës:

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

Pk1 _____	Pikët e kriterit që vlerësohet
Vmin k1	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
Pmaxk1	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
Ok1	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Sqarim: Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsioneve. Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

3.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

3.2.2 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, si më mëposhtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;

- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve* janë më shumë se ± 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar

3.3 Ofertat anomalisht të ulëta

3.3.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me mallrat e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.3.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP .

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta
M_O – Mesatarja e Ofertave të vlefshme
n – Numri i Ofertave të vlefshme
Z_M – Zbritja e Mundshme

$$\mathbf{M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \ldots O_n / n}$$

$$\mathbf{Z_M = 85\ \%\ Mo}$$

Vlera e Ofertës që vlerësohet <ZM..... , <u>si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët</u>

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

3.4. Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

Seksioni 4. <u>Nënshkrimi i Kontratës</u>

4.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 14. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

4.2 Sigurimi i kontratës

4.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas Shtojcës 19 të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

4.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
i. garanci bankare

ii. garanci sigurimi

Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.

4.3 **Njoftimi i kontratës së nënshkruar**

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Shënim: Autoritetet kontraktore nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 4.

III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

Shtojca 1: Formulari i Ofertës ekonomike
Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje
Shtojca 2/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur
Shtojca 3: Ftesa për Ofertë në rastin e Marrëveshjes Kuadër
Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës
Shtojca 5: Formulari i Informacionit Konfidencial
Shtojca 6: Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik
Shtojca 7: Deklarata për konfliktin e interesit
Shtojca 8: Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme
Shtojca 8/1: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave Ligjore në marëdhëniet e punës
Shtojca 9: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes
Shtojca 10: Specifikimet teknike
Shtojca 11: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër
Shtojca 12: Sasia e mallrave dhe kushtet e lëvrimit
Shtojca 13: Formulari për Njoftimin S'kualifikimit
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit
Shtojca 15 Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomike të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
Shtojca 16: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
Shtojca 17: Kushtet e Vecanta të Kontratës
Shtojca 18: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar
Shtojca 18/1: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike
Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës
Shtojca 20: Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor
Shtojca 21: Draft Marrëveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara
Shtojca 22: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara
Shtojca 23: Formulari i Njoftimit të Anulimit

Shtojca 1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit_____

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; me TVSH

1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Nr	**Përshkrimi i mallrave**	**Sasia**	**Çmimi Njësi**	**Çmimi Total**	**Afati**
1	Punime civile jo te specializuara	1/set			180 dite
2	FV. Dere zjarrduruese	1/cope			180 dite
3	F.V. Rack 42U 800 mm x 1200 mm me aksesoret perkates	6/cope			180 dite
4	FV. Dysheme teknologjike	42/m²			180 dite
5	FV. Panelet Elektrike te kompletuar me te gjithe aksesoret per montim	2/set			180 dite
6	Instalime elektrike ne dhomen e serverave të qendrës së vazhdueshmërisë së biznesit (BCC Site) (perfshi ndricuesit linear, ndricues emergjence dhe aksesoret perkates, kanalinat dhe kabllot, tokezim etj.)	1/set			180 dite
7	FV. Sistem UPS 40 kVA	2/cope			180 dite

8	F.V. Shpërndarësit e energjisë (PDU) 32A	12/cope			180 dite
9	FV. Sistem Kondicionimi rreth 34 kW	2/set			180 dite
10	FV. Rrjet të transmetimit të të dhënave (Network Pasiv) (perfshi kabllim i paraterminuar Bakri dhe Fiber Multimode OM4, Patch Panele, Patch Guide, aksesore etj.)	1/set			180 dite
11	FV. Sistem i video-monitorimit (7 Kamera, NVR dhe switch me PoE)	1/set			180 dite
12	FV. Sistem Access Control per deren (Kontrolleri, lexuesit, magneti)	1/set			180 dite
13	F.V. Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit (përfshi ndërfaqen e komunikimit me UPS, me sistemin e kondicionimit, me sistemin e dedektimit dhe fikjes së zjarrit, me panelet elektrike dhe me shpërndarësit e energjisë në Rack-e (PDU-të) dhe parametrat e ambjentit	1/set			180 dite
14	F. V. Sistem i detektimit dhe fikjes se zjarrit (përfshi panelin e kontrollit, detektorët e tymit dhe të temperatures, sirenat, cilindrin me agjentin e shuarjes, pajisjet e sinjalizimit (Alarmit), butonat e aktivizimit dhe ndalimit manual, tubat dhe nozolat e shkarkimit, Valvulat e shkarkimit, sprucatorët etj.	1/set			180 dite
15	Switch Layer 3	2/cope			180 dite
16	Server	2/cope			180 dite
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____(kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 2

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje*]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit_____

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Marzhi ynë i fitimit i shprehur në përqindje është si më poshtë:

1	**2**	**3**	**5**
Nr	**Përshkrimi i mallrave**	**Marzhi i fitimit i shprehur në perqindje**	**Afati i levrimit**

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 2/1

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë:_____; nga Autoriteti Kontraktor: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik_____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të:_____që:
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës,është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

   a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
   b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

   a) çmimet ;
   b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
   c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
   d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

_____

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

_____ _____

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

Shtojca 3

[*Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit]*

FTESA PËR OFERTË

(*shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor*)
fton për të paraqitur oferta në procedurën për furnizimin e mallrave të mëposhtme:
……
……
……
(*jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasisë siç përkufizohet në Dokumentat e Tenderit (DT).*

Vendi i Dorëzimit të Mallit
(jepni nje pershkrim te shkurter)

Malli duhet të dorëzohet brenda datës _____

Oferta duhet të paraqitet
……
[*Jep adresën e saktë*]
Përpara
……
[*Përcaktoni datën dhe orën*]
Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese _____

Forma e komunikimit:

Me shkrim ☐ elektronike (email, fax, etj) ☐

Shtojca 4.

[*Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik, kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti*]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

KUJDES

Çdo e dhënë, që nuk është regjstruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i k**ë**tyre t**ë** drejtave ka dh**ë**n**ë** vet**ë** p**ë**lqimin p**ë**r dh**ë**nien e informacionit p**ë**rkat**ë**s dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE REALIZIMIN E OBJEKTIT SIPAS GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor_____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____,me cilësinë e _____ të personit juridik _____deklaroj se:

Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratësi dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË
Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor_____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

_____

Vula

Shtojca 8

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____me cilesinë _____të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik,*** si më poshtë:

  _____
  _____
  _____etj.

  nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP[3].

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

[3] Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

SHENIM: Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik duhet te dekalrojne emer, atesi, amesi, mbiemer, datelindje, vendlindje, me qellim verifikimin e tyre ne Regjistrin Kombetar te Vendimeve Penale.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____
Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 8/1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në proçedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____me cilësinë e _____të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____
Përfaqësuesi i ofertuesit
Nënshkrimi
Vula

Shtojca 9

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 8/1;
e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Objekti i veprimtarise se Operatoreve Pjesemares duhet te perputhet me objektin e prokurimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Kopje të certifikuara të bilanceve të paraqitura në autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore) te tre viteve te fundit, konkretisht te viteve 2017, 2018, 2019.

b. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore per tre vitet e fundit, ku xhiroja mesatare e tre viteve, konkretisht 2017, 2018, 2019 të mos jete me vlerë më të ulët se 36,000,000 (Tridhjete e gjashte million) leke pa tvsh.

c. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vertetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlera duhet të jetë në një vlerë jo më të vogel se 36,000,000 (Tridhjete e gjashte million) leke pa tvsh.

Ne rast se kontrata eshte kryer me ente publike:

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Ne rast se kontrata eshte kryer me sektorin privat:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori i sherbimit duhet te disponoje certifikatat e meposhtme:

a) **ISO 9001** per sistemin e menaxhimit te cilesise (te vlefshme), ose ekuivalente, të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen;

b) Certifikatën per menaxhimin e sherbimeve **ISO 20000-1:2011** ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen,

c) Certifikatën per menaxhimin e informacionit **ISO 27001** ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.

d) Certifikatën per menaxhimin e ambjentit **ISO 14001** ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.

Çertifikatat te jene te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas aktmarrëveshjes.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

1. NS-12 A Impiante teknologjik termike dhe te kondicionimit
2. NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
3. NS-14 A Impiante te brendshme elektrike telefoni radiotelefoni

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose distributori për paisjet e mëposhtme:

- Panelet elektrike.
- Dysheme Teknologjike
- Kondicionerë të preçizionit të lartë
- Racks
- PDU
- BMS
- UPS per dhomene e serverave
- CCTV
- Akses Kontroll
- Sistem Detektim dhe Fikje Zjarri
- Rrjetin Data network dhe fiber optike
- Switch Layer 3
- Server

Paisjet duhet të jenë të reja (jo Refurbished). Në autorizim prodhuesi duhet të jenë ë shënuar: emri i prodhuesit, emri i personit të autorizuar nga prodhuesi, te dhena mbi kompanine si : numri i telefonit te prodhuesti, adresë e-mail. Ne rast te paraqitjes se autorizimit te distributorit duhet te provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë punësuar minimalisht 13 persona, për periudhën Dhjetor 2020 – Shkurt 2021 të vërtetuar me:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ose nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku te specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.

2. Listë pagesa e Kontributeve te Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore

2.3.6 Operatori ekonomik duhet ketë pjese te stafit te tij, për periudhën **Dhjetor 2020 – Shkurt 2021** (vertetuar nga Liste-pagesa e Kontributeve te Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore, kerkuar ne piken persona te certikuar**:**

- 1 (një) inxhinier mekanik,mekatronik i certifikuar nga prodhuesi për sistemet e kondicionimit qe do te ofertoje.
- 1 (një) inxhinier elektrik, ose inxhinier elektronik, informatikë, për sistemet e UPS qe do te ofertoje.
- 1 (një) inxhinier elektrik, ose inxhinier elektronik, informatikë, i certifikuar nga prodhuesi per sistemin e BMS qe do te ofertoje.
- 1 (një) inxhinier elektrik, i certifikuar per panelet elektrike qe do te ofertoje.
- 1 (një) inxhinier elektronik,telekomunikacioni, informatikë i certifikuar për sistemin e Kamerave qe do te ofertoje.
- 1 (një) inxhinier elektronik,telekomunikacioni, informatikë i certifikuar për sistemin e akses kontrollit qe do te ofertoje
- 1 (një) inxhinier elektronik,telekomunikacioni, informatikë i specializuar per ndertimin e rrjetit Data dhe fiber optike qe do te ofertoje
- 1 (një) inxhinier elektronik,telekomunikacioni, informatikë i certifikuar për sistemin e zjarrit qe do te ofertoje.
- 5 (pese) specialist ose teknik te pajisur me kartela te sigurimit teknik

Per te vertetuar sa me siper operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Per inxhinierat, Diploma inxhinierike, Kontrate Pune, CV dhe certifikata perkatese e prodhuesit.
- Per specialistet ose tekniket, Kontrate Pune, CV certifikatat perkatese.

Inxhinieret, specialist apo tekniket duhet te jene pjese e stafit te operatotit ekonomik per periudhen **Dhjetor 2020 – Shkurt 2021** vertetuar me liste- pagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore.

Nje specialist, teknik, inxhinier mund te kete 1 ose disa certifikime.

2.3.7 Për integrimin në BMS të paisjeve të sistemit elektrik, sistemit të kondicionimt me fryerje nga poshtë, UPS, PDU-së, paneleve elektrike, mateseve te tensionit, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion që verteton integrimin e tyre.

2.3.8 Në rast se produktet janë të prodhuesve të ndryshëm, ofertuesi duhet të paraqesë vertetim nga secili prodhues, si ai i sitemeve ashtu dhe nga prodhuesi i BMS për integrimin e tyre. ***Mos paraqitja e vertetimeve nga cdo prodhues është kusht për skualifikim.***

2.3.9 Për secilin nga zërat duhet të paraqiten projektet dhe skemat e detajuara se si do të bëhen instalimet nga ofertuesi në përmasa reale për të evituar çdo lloj problematike që mund të lindë për arsye hapsire apo mos funksionimi sitemi.

Per te gjitha pajisjet duhet te paraqitet katalog dhe/ose datasheet origjinale perkates qe vertetojne plotesimin e kerkesave teknike

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj: Sipas materialit bashkelidhur ne PDF

Specifikimi i Materialeve: Sipas materialit bashkelidhur ne PDF

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Subjekti duhet te siguroje Shperndarjen ne cdo pike te OSHEE brenda Tiranes dhe ne te gjitha rrethet e Shqiperise sipas listes se meposhtme

1. OBJEKTIVAT, QELLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

1.1. Objektivi i Përgjithshëm

Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike sh.a. kerkon te ndertoje nje Dhome Serverash BCC per te mbeshtetur ruajtjen e te dhenave si edhe mbarevajtjen e sherbimeve dhe misionin kritik te aplikimeve te IT-se. Kjo Dhome Serverash duhet te jete e kompletuar me Sistem Kondicionimi, UPS, CCTV, Access Control, Sistem Menaxhimi, Monitorimi dhe Kontrolli (BMS), Rack dhe PDU, Sistem te Detektimit dhe Shuarjes se zjarrit, sistem Network pasiv baker, fiber optike Multimode etj.

1.2. Qëllimi

Qellimi i ketij projekti konsiston ne:

1- Ndertimin e Dhomes se Serverave BCC sipas standardeve kombetare dhe nderkombetare;
2- Garantimin e funksionimit te infrastruktures kompjuterike ne kushte normale dhe ne kushte emergjence;
3- Garantimin e fleksibilitetit te infrastruktures fizike;
4- Minimizimin e mundesise se mosfunksionimit te sistemeve te informacionit nga faktore te jashtem;
5- Rritjen e sigurise se informacionit.

Per realizimin e ketij projekti do te kryhen punime civile jo te specializuara dhe blerje e pajisjeve te tilla si Kondicioner, UPS, Sistem Zjarri, Sitem Network Pasiv, Sistem CCTV, Sistem Access Control, Rack, PDU etj. Gershetimi i ketyre pajisjeve me sistemet perkatese do te garantojne nje infrastukture te pershtatshme per ofrimin e sherbimeve te sigurta, online 24/7, per OSHEE sh.a. Dhoma e Serverave do te ndertohet ne godinene e Magazines ne Drejtorine Rajonale Vlore.

1.3. Rezultatet qe duhet te arrihen

Per krijimin e Dhomes se Serverave BCC, Operatori Ekonomik duhet:

a) Te realizoje punime civile (punime jo te specializuara), pershtatje funksionale te ambjentit.
b) Te realizoje punime te pergjithshme ku perfshihen: dysheme teknologjike, sistemi i tokezimit brenda dhomes, punime mekanike/elektrike, etj.
c) Te furnizoje dhe instaloje dere zjarrduruese
d) Te furnizoje panelet elektrike si dhe te beje instalimet elektrike te brendshme ne dhome.
e) Te furnizoje dhe instaloje Sistemin e Kondicionimit.
f) Te furnizoje dhe instaloje pajisjet e Network Pasiv Baker dhe fiber optike Multimode.
g) Te furnizoje dhe instaloje Sistemet e Sigurise CCTV dhe Access Control.
h) Te furnizoje Sistemin e Monitorimit, Kontrollit dhe Menaxhimit (BMS-se) dhe te realizoje konfigurimet perkatese te sistemit per monitorimin e dhomes se serverave.
i) Te furnizoje dhe instaloje Rack dhe PDU.
j) Te realizoje testimin e sistemeve te realizuara ne kete projekt.
k) Te beje menaxhim dhe koordinim te pergjithshem te projektit.

2. GARANCIA

Periudha e garancise per dhomen e serverave dhe te gjithe sistemet qe jane pjese e ketij projekti do te jete 1 vit.

3. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PER NDERTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi/Njesi	Vlera
1	Punime civile jo te specializuara	set	1		
2	FV. Dere zjarrduruese	copë	1		
3	F.V. Rack 42U 800 mm x 1200 mm me aksesoret perkates	cope	6		
4	FV. Dysheme teknologjike	m2	42		
5	FV. Panelet Elektrike te kompletuar me te gjithe aksesoret per montim	set	2		
6	Instalime elektrike ne dhomen e serverave të qendrës së vazhdueshmërisë së biznesit (BCC Site) (perfshi ndricuesit linear, ndricues emergjence dhe aksesoret perkates, kanalinat dhe kabllot, tokezim etj.)	set	1		
7	FV. Sistem UPS 40 kVA	copë	2		
8	F.V. Shpërndarësit e energjisë (PDU) 32A	copë	12		
9	FV. Sistem Kondicionimi rreth 34 kW	set	2		
10	FV. Rrjet të transmetimit të të dhënave (Network Pasiv) (perfshi kabllim i paraterminuar Bakri dhe Fiber Multimode OM4, Patch Panele, Patch Guide, aksesore etj.)	set	1		
11	FV. Sistem i video-monitorimit (7 Kamera, NVR dhe switch me PoE)	set	1		
12	FV. Sistem Access Control per deren (Kontrolleri, lexuesit, magneti)	set	1		
13	F.V. Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit (përfshi ndërfaqen e komunikimit me UPS, me sistemin e kondicionimit, me sistemin e dedektimit dhe fikjes së zjarrit, me panelet elektrike dhe me shpërndarësit e energjisë në Rack-e (PDU-të) dhe parametrat e ambjentit	set	1		
14	F. V. Sistem i detektimit dhe fikjes se zjarrit (përfshi panelin e kontrollit,	set	1		

	detektorët e tymit dhe të temperatures, sirenat, cilindrin me agjentin e shuarjes, pajisjet e sinjalizimit (Alarmit), butonat e aktivizimit dhe ndalimit manual, tubat dhe nozolat e shkarkimit, Valvulat e shkarkimit, sprucatorët etj.				
15	Switch Layer 3	cope	2		
16	Server	cope	2		
TOTALI PA TVSH / LEKE					
TVSH (20%) / LEKE					
TOTALI ME TVSH / LEKE					

4. KERKESA FUNKSIONALE

Me ane te ketij projekti synohet krijimi i nje Dhome Serverash BCC per Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike (OSHEE) sh.a., ne te cilen do te alokohen te gjitha pajisjet me sistemet perkatese per mbrojtjen dhe ruajtjen e informacionit. Qellimi i ketij projekti eshte te krijoje kushtet e nevojshme dhe te domosdoshme per ambientin e Dhomes se Serverave, ku do te hostohen pajisjet IT. Dhoma e Serverave kerkohet qe te hostoje 6 (gjashte) Rack-e, me lartesi 42U dhe permasa minimalisht 800 mm Gjeresi dhe 1200 mm Thellesi. Hapesira ne shfrytezim te Dhomes se Serverave eshte rreth 42 m^2.

4.1. Konceptimi i zhvillimit te projektit

Dhoma e Serverave

Nisur nga objektivat e projektit, me rendesi eshte krijimi i nje infrastrukture per hostimin e pajisjeve IT ne menyre te perqendruar ne nje qender te dhenash dhe garantimi i funksionimit te infrastruktures kompjuterike ne kushte normale dhe ne kushte emergjence duke marre ne konsiderate rendesine e mbrojtjes se ketij ambienti, ne te cilin ruhen te dhena sensitive dhe jane te perqendruara pajisjet kompjuterike, mekanike, elektrike. Pershtatja funksionale e ambienteve duhet te mbuloje punime dhe aktivitete te pergjithshme te ndertimit (pa perfshire punimet/instalimet e specializuara) per krijimin e Dhomes se Serverave BCC, ne nje siperfaqe rreth 42m^2, ne te cilen do te kete nje kapacitet prej 6 Rack-esh.

Infrastruktura mekanike

Infrastruktura mekanike perfshin sistemin e ftohjes se pajisjeve kritike te Dhomes se Serverave BCC (Pajisje Outdoor – Kondenser te instaluar jashte dhe njesia e brendshme e Sistemit CRAC (Computer Room Air Conditioning)). Ne dhome eshte parashikuar qe sistemi i ftohjes te jete i teknologjise Precise Cooling, me fryrje nga poshte (down flow type), me shperndarje direkte dedikuar per Dhome Serverash.

Kondicionimi duhet te garantoje funksionimin redundant te dy ose me shume sistemeve, si edhe funksionimin ne paralel, per zgjerim kapaciteti ne te ardhme. Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike (OSHEE) sh.a. ka perllogaritur qe Sistemi i Kondicionimit (CRAC) duhet te kete nje fuqi ftohese rreth 34 kW. Kapaciteti i sistemit te ftohjes eshte llogaritur duke u bazuar ne emetimin e nxehtesise qe kane pajisjet si Rack, UPS etj.

Dhoma e Serverave duhet te jete e pajisur me dysheme teknologjike dhe te gjithe instalimet (shperndarja e kabllove te energjise dhe te dhenave) duhet te behen me kanaline metalike nen dysheme.

Infrastruktura elektrike

Pajisjet Hardware te nje Dhome Serverash jane te ndjeshme ndaj luhatjeve ose shkeputjeve te energjise elektrike. Ne veçanti, furnizimi me energji elektrike eshte nje çeshtje kritike per funksionimin e Sistemeve IT, ku rreth 30% e demtimit te pajisjeve kompjuterike, pajisjet e rrjetit, dhe automatizimit jane shkaktuar nga luhatjet ose shkeputjet e tensionit ne rrjetin e furnizimit te dhomes se serverave. Problem i madh ne fushen e TIK qe duhet te mbahet ne konsiderate eshte edhe llogaritja jo e sakte e ngarkeses elektrike ose llogaritja gabim e llojit dhe madhesise se kabllove, siguresave dhe pajisjeve te tjera elektrike. Te gjitha kabllot elektrike, qe vijne nga panelet elektrike te Dhomes se Serverave, duhet te kalojne neper kanalina poshte dyshemese teknologjike. Duhet te instalohen dy panele elektrike ne menyre qe te sigurohet redundance 2N per furnizimin dhe shperndarjen e energjise elektrike ne dhomen e serverave.

Po ashtu, duhet te instalohen 2 UPS 40 kVA te cilat do te sigurojne furnizimin me energji te panderpre ne redundance 2N. Si edhe çdo Rack duhet te pajisjet me nga 2 pajisje te shperndarjes se energjise elektrike (PDU), 32A.

Lidhja IT / Network

Rrjeti pasiv midis rack-eve ne Dhomen e Serverave eshte i nje rendesie te madhe per funksionimin e duhur te komunikimit midis rack-eve me njeri-tjetrin. Per te siguruar rrjedhjen e informacionit te duhur ne dhomen e serverave duhet te realizohet lidhje me kabell bakri Cat 6A LSZH dhe fiber Multimode OM4 LSZH, te para-terminuar nga fabrika, midis rackeve.

Sisteme te tjera

Dhoma e serverave duhet te pajiset gjithashtu edhe me sistemet si me poshte vijojne:

- Sistemi i Survejimit CCTV
- Sistemi i Access Control
- Sistemi i Monitorimit, Kontrollit dhe Menaxhimit (BMS)
- Sistemi i Access Control
- Sistemi i Detektimit dhe Shuarjes se Zjarrit

Specifikime Teknike

4.2. Ambienti i dhomes se serverave

Dhoma e re e serverave do të konsolidojë të gjithë infrastrukturën e pajisjeve pasive dhe aktive për OSHEE BCC. Dhoma e re e serverave do të ketë një sipërfaqe rreth 42 m^2, me permasa 7 m x 6 m. Kjo dhome e re e serverave do të ketë një kapacitet prej 6 Rack-ësh me ngarkese rreth 5 kW secili Rack. Racket duhet te instalohen ne dy rrjeshta te vendosur perballe njeri – tjetrit dhe korridori midis rrjeshtave te Rack-eve te jete me grilat per qarkullimin te ajrit te ftohte nga kondiciomi i dhomes se serverave. Eshte konceptuar qe ambjenti i dhomës së serverave të organizohet si më poshte, ku paraqitet planimetria e dhomës dhe vendosja e pajisjeve ne menyre ilustruese. Ofertuesi duhet te propozoje zgjidhjen e tij duke dorezuar projektin e plan-vendosjes se pajisjeve ne zgjidhjen e projektit.



Figure 1. Planimetri ilustruese e plan-vendosjes se pajisjeve ne dhome

Shpërndarja e kabllove të energjisë dhe e të dhënave do bëhet poshtë dyshemesë teknologjike.

OSHEE ka përllogaritur që sistemi i kondicionimit (CRAC) do të ketë një fuqi ftohëse rreth 34 kW dhe UPS do te jene 40 kVA me autonomi 15 minuta ne 100% ngarkese. Dhoma e serverave BCC do të jete e pajisur me sistem kondicionimi të preçizionit të lartë, redundant, me fryrje nga poshtë (down flow type), me shpërndarje direkt, qe do te realizoje ftohjen e dhomes se serverave me ajër të kondicionuar. Ofertuesi duhet të paraqesë vendosjen e pajisjeve të kërkuara me emërtimin dhe përmasat reale për të evituar çdo gabim të mundshëm. Lartësia e dhomës ku është menduar ndertimi i dhomes se sererave eshte 3.5 m.

Dhoma e serverave duhet te pajisjet edhe me sistem te detektimit dhe shuarjes se zjarrit. Dhe per monitorim sa me te mire te saj duhet te instalohet edhe nje sistem monitorimi, menaxhimi dhe kontrolli (BMS) per matjen e parametrave optimale te operimit te dhomes si temperature ne dhome, lageshtia ne dhome, prezenca e ujit apo monitorim dhe menaxhim i sistemeve te dhomes si UPS, CRAC etj.

Rack-et ne dhomen e serverave duhet te komunikojne me ane te njeri-tjetrit me ane te teknologjive baker Cat 6A dhe fiber optike Multimode OM4 te para-terminuara nga fabrika.

4.3. Pershtatja funksionale e ambjenteve

Punimet do të mbulojnë punime të përgjithshme të ndërtimit të një dhome serverash (pa përfshirë instalimet e specializuara). Ofruesi është përgjegjës për zhvendosjen e sigurtë të mbetjeve të materialeve të ndërtimit si dhe për pastrimin rregullisht të ambienteve. Hedhja e materialeve të mbetura do të kryhet në përputhje me ligjet dhe rregulloret, për menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit si dhe riciklimit në Republikën e Shqipërisë. Ofruesi është përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e gjithë bazës materiale.

Do të kryhet lyerja e dhomes se serverave ku do të instalohen pajisjet. Punimet që do të kryhen janë shtrimi i dyshemesë, instalimi i ndriçimit normal dhe te emergjences në tavan. Parashikohet të bëhet izolimi nga lagështira si dhe lyerja e dyshemesë me bojë epoxite kundra lagështirës si dhe perimetrit të mureve deri në lartësinë 35-40 cm. Gjithashtu, për këtë ambient do të parashikohet derë zjarrduruese REI60.

4.3.1. Punime civile jo te specializuara

Ndertimi i dhomës dhe përshtatja e ambientit ku përfshihen punime si më poshtë:

a) Prishje dhe largim të materjaleve në mënyrë të sigurtë
b) Lyerje e dyshemesë dhe mureve deri në lartësinë 35-40 cm me bojë epoxite.
c) Zhvendosje e deres ekzistuese sipas nevojes ne varesi te zgjidhjes se ofertuar
d) Vendosje derë zjarrduruese 60 min me permasa minimalisht 105-120 cm x 220-240 cm dhe me hapje nga jashtë me dorezë antipanik dhe me mekanizëm vetëmbyllës
e) Patinime
f) Lyerje të ambientit
g) Veshje muresh me termoizolim
h) Bazament për kondesuesit e kondicionerit, kondicionerin dhe UPS

4.3.2.Dyshemeja Teknologjike

Dhoma e serverave do të jetë e pajisur me dysheme teknologjike. Dyshemeja teknologjike mendohet të jetë e lartë 40-50 cm poshtë së cilës do të bëhen pjesa me e madhe e instalimeve elektrike, Network-ut, kondicionimit, etj.

Dyshemeja teknologjike me një sipërfaqe rreth 42 m^2 do të jetë me peshëmbajtje të tillë që të mbajë pajisjet të cilat do të instalohen. Pajisjet e renda si kondicionerët do të instalohen mbi bazamente të veçanta që të eliminohet mbingarkesa në dyshemenë teknologjike.

Dyshemeja teknologjike duhet te përbëhet nga:

- Pllaka me dimensione 600x600mm dhe 600x1000mm, si dhe grila për rregullim të fluksit të ajrit.
- Struktura mbështetëse e përbërë tërësisht nga çeliku i galvanizuar
- Këmbë (piedestal) me rregullim të lartësisë
- Traversat (stringers) të përbëra prej profili "C" janë të vendosura në pjesën e poshtme për të rritur qëndrueshmërinë ndaj përkuljeve
- Material plastike i zi kundra zjarrit i montuar në pjesën e sipërme të traversës

Pllakat

Materiali i pllakave te perdorura per dyshemene teknologjike duhet te jete material mineral i perforcuar me fibra per te permbushur nevojat per peshembajtje. Kompozimi i pllakave duhet te permbushe parametrat e meposhtme:

- Dimensionet e pllakave 600x600mm/600x1000 mm
- Trashesia: 38 mm
- Densiteti mesatar i drurit te pllakes duhet te jete jo me pak se 720 Kg/m3 (+/-5%)
- Pjesa anesore te jete e veshur me plastik te dallueshme ngjyre te zeze
- Pjesa e poshtme e pllakes duhet te jete me veshje alumini

Aksesoret e ajrimit

Per te siguruar nje efikasitet sa me te mire te fryrjes se ajrit te ftohte dyshemeja teknologjike duhet te jete e pajisur me aksesore ventilimi per te bere te mundur qarkullimin e ajrit te ftohte nga poshte dyshemese ne pjesen ballore te rack-eve. Ky ventilim duhet te realizohet nepermjet grilave te ajrimit (panele metalike) te cilat duhet te kene karakteristikat e meposhtme:

- Te jene ne dimensionet 300x600mm/600x600mm
- Te jene te pershtatshme per dyshemene teknologjike
- Te kene konstrukt metalik (te gjitha pjeset metalike te jene te lyera)
- Te jene te te njejtit prodhues me pllakat

Rampe ose Shkalle

Për lehtësimin e futjes së pajisjeve të rënda si dhe per te mundesuar hyrjen e personelit ne dhome (lartesi e dysheme 40-45 cm), do ndërtohet një rampe (pedanë) ose strukture me dy shkalle brenda dhomes se serverave. Kontraktori duhet të ketë parasysh sigurinë e përdoruesve ne zgjidhjen qe

do te propozoje. Per te garantuar sigurine e perdoruesve, ne te dy rastet duhet te jete siperfaqe jo e rreshkitshme.

Dyshemeja teknologjike, para dorëzimit, duhet të pastrohet duke siguruar qe ne dhome mos kete pluhura/ndotje te cilat do te ishin te demshme per pajisjet e vendosura ne dhomen e serverave si UPS, kondicioner (CRAC) etj.

4.4. Infrastruktura e Sistemit Elektrik

4.4.1. Të Përgjithshme

Instalimet kabllore duhet të jenë të ngjashëm me rregulloret ndërkombëtare në lidhje me kodimin e ngjyrave, çelësat, prizat, si dhe specifikimet e sigurisë dhe tokëzimit. Duhet bërë etiketimi i duhur për të shënuar të gjitha kabllot dhe instalimet elektrike, paralajmërime të sigurisë, të cilat nuk mund të dallohen nga ngjyrat.

Rrjeti elektrik duhet të dizajnohet në mënyrë që:

a) Në rastin e dështimit të furnizimit me energji elektrike të sigurohet kalimi në bypass.
b) Të jetë i disponueshëm dhe funskional në mënyrë të vazhdueshme.
c) Furnizim i pandërprerë me energji elektrike (UPS).

Panelet e fuqisë do të projektohet dhe instalohet në përputhje të kërkesave për furnizimin me energji elektrike të qendrave të përpunimit të të dhënave.

Panelet elektrike shërbejne për furnizimin dhe shperndarjen e energjise elektrike të gjithë pajisjeve dhe aksesorëve të Dhomes se Serverave. Furnizimi me energji elektrike i paneleve te fuqise per dhomen e serverave nuk eshte pjese e ketij projekti. Panelet do të furnizojnë me energji elektrike kondicioneret, prizat e shërbimit, ndriçimin normal dhe te emergjences, si edhe UPS-te.

Dalja e UPS duhet te vijë përsëri në këtë panel i cili do të funizojë automatin kryesor prej të cilit furnizohen automatet që janë të dedikuar për PDU-të e instaluara nëpër Rack si dhe pajisje te tjera qe kerkojne furnizim te panderprere si BMS-ja, Centrali i Zjarrit, centrali i Access Control etj.

Panelet elektrike duhet të jenë te pajisur me aparatet matës për çdo seksion. Automatet e instaluar do të pajisen me kontakte ndihmës për të mundësuar marrjen e informacionit për statusin e automatit (ON/OFF), per sistemin e monitorimit, menaxhimit dhe kontrollit (BMS).

Paneli duhet të jetë metalik dhe derë xhami me shkallë mbrojtje IP 40. Hyrje-Dalje (Poshtë-Lart). Montimi do të bëhet në mur ose në dysheme në një pozicion ku mund të shikohet nga kamera dhe do të parashikohet 25% hapësirë e lirë.

4.4.2. Panelete Elektrike

Karakteristikat kryesore:

- Arkitektura e panelit elektrik do te reflektoje dhe mënyrën e lidhjes
- Fleksibiliteti i sistemit do te lejoje ndryshimet gjatë implementimit
- Lehtësisht i montueshëm, lehtësisht i konfigurueshëm
- Lidhje me sistemin e menaxhimit

Panelet elektrike duhet te kene specifikimet si me poshte:

Mjedisi:

- Temperatura e ambjentit: standarte
- Temperatura mesatare: 35°C
- Lageshtira relative: (80% - 35°C)

Karakteristika elektrike

- Tensioni i izolimit: 1000 V
- Tensioni i punës 400 V
- Frekuenca: 50/60 Hz
- Rryma: 160 A
- Lidhja e shkurter e kerkuar: 20 kA
- Sistemi i zbarave: TNC-TNS

Karakteristikat e kuadrit:

- Shkalla e mbrojtjes jashte IP: 40
- Shkalla e mbrojtjes brenda IP: 20
- Shkalla e mbrojtjes mekanike IK: 07
- Dera: me çelës

Për efekt sigurie, sidomos kur dyert e panelit janë të hapura, të gjitha zbarat duhet të mbulohen në të gjithë sipërfaqen e tyre.

Për të lehtësuar aksesin ne panelet elektrike në rastet kur do të bëhen veprime për mirëmbajtjen paneli duhet të përbëhet nga pjesë të çmontueshme. Për të siguruar mbrojtje maksimale ndaj njerëzve, pjastrat ballore të të gjitha paisjeve duhet të instalohen në pjesën e përparme, për të shmangur aksesin e drejpërdrejtë në pjesën që nuk janë të izoluara.

Hapësira e lirë në këto panele nuk duhet të jetë më pak se 25%. Kontraktori duhet te dorezoje skemat elektrike te paneleve te propozuar ne zgjidhjen teknike.



Figure 2. Skeme ilustruese e panelit elektrik

4.4.3. Ndriçimi normal

Për ndriçimin e ambjentit duhet respektuar kushti prej 500 Lux në planin horizontal dhe 200 Lux në planin vertikal, e matur kjo 1m mbi dyshemenë e ngritur në aksin e korridoreve ndërmjet Rack-eve.

Për ndriçimin normal të ambjenteve mendohen ndriçuesa floreshent (starter elektronik). Pozicionimi duhet të jetë paralel me reshtin/tat e vendosjes së paisjeve dhe jo në pjesën mbi pajisje me qellim që të ndriçohet zona para e mbrapa tyre. Komandimi (ndezja/fikja) duhet të jetë në grupe. Furnizimi i ndriçimit duhet të bëhet me kabëll 1.5mm^2 të futur në tub ridgid. Instalimi i ndriçimit duhet të plotësojë të gjitha kushtet e sipërpërmendura për mbrojtjen e kabllove dhe percjellësave. Komandimi i ndriçimit duhet të realizohet me çelës. Duhet te instalohen minimalisht 6 ndriçues ne dhome.

4.4.4. Ndriçimi i emergjencës

Ndriçimi i emergjencës eshte parashikuar qe te realizohet me ndriçues te veçante. Ndriçuesit duhet te sigurojne ndriçim per te pakten 1 ore qe nga nderprerja e energjise. Ndriçuesit e emergjences duhet te tregojne gjendjen e ndriçuesit dhe te baterive si edhe te pajisen me sinjalistiken perkatese. Duhet te instalohen minimalisht 3 ndriçues te emergjences ne dhome.

4.4.5. Sistem UPS 40 kVA

UPS-të duhet te instalohen per te siguruar mbrojtjen dhe autonomine e pajisjeve te instaluara ne dhomen e serverave. Kapaciteti i UPS-ve do te jete **40 kVA,** 3 faza ne hyrje dhe 3 ne dalje. UPS-të duhet te garantojne autonomi per min. 15 minuta në 100% ngarkese.

UPS do te jete i teknologjise “On-Line”, me konvertim dyfish AC-DC dhe DC-AC. Sistemi baze i UPS duhet te kete rectifier, konvertuesin e baterise, inverterin, panelin e kontrollit per operimin dhe monitorimin, server komunikimi te integruar dhe procesorin e sinjaleve dixhitale (DSP).
Nese energjia nga rrjeti nderpritet ose parametrat jane jashte rangut te lejuar nga hyrja e UPS, atehere UPS do te perdore baterite per te furnizuar me energji pajisjet per nje kohe te caktuar.
UPS duhet te kete te integruar nje “bypass” emergjence. Ky “bypass” duhet te perfshije celesin statik dhe kontaktor mbrojtje.
UPS-ja duhet te monitoroje vazhdimisht linjen hyrese te energjise dhe duhet te filtroje apo normalizoje parragullesite e parametrave ne hyrje.

Specifikimet Teknike

Dalja (Output-i)	
Fuqia	40 kW / 40 kVA
Tensioni Nominal ne Dalje (Output)	400V 3PH
Rregullimi tensioni ne Dalje (Output)	Konfigurim per 380 : 415 V
Rregullimi tensioni ne Dalje (Output)	Me pak se 5%
Frekuenca ne Dalje (Output)	50/60 Hz
Tensione te tjera (Other)	380, 415V
Topologjia	Konvertim dyfish (Double Conversion) Online
Forma e vales	Sinusoidale
Toleranca e tensionit ne dalje (Output)	+/- 2% statik dhe 100% ndryshim ngarkese
Deformimi total i harmonikave te sinjalit te tensionin ne dalje (Output THD)	< 3% ngarkese lineare dhe < 5% ngarkese jolineare
Hyrja (Input-i)	
Tensioni Nominal ne Hyrje (Input)	400V 3PH
Frekuenca ne Hyrje (Input)	45 - 65 Hz
Lidhja ne Hyrje (Input)	Kabell (3PH + N + G)
Diapazoni i tensionit ne Hyrje (Input) per operim normal	340 - 465V
Tensione te tjera ne Hyrje (Input)	380, 415
Deformimi total i harmonikave te sinjalit te tensionit ne hyrje (Input)	< 5% per ngarkese te plote
Baterite	
Tipi i Baterise	Bateri e vulosur me acid -plumb
Autonomia	jo me pak se 15 min ne 100% ngarkese
Nderfaqe rrjeti	Po
Panel kontrolli	LCD Multi-funksional dhe tastjere kontrolli

Buton emergjence (EPO)	Po
Ambjenti	
Ambjenti i punes	0 - 40 °C
Niveli i lageshtires	0 - 95%
Zhurma nga 1m largesi	< 65 dBA
Shkalla e mbrojtjes	IP 20
Konformiteti	
Konform standarteve	CE, EN/IEC 62040-1-1, EN/IEC 62040-2, EN/IEC 62040-3, IEC 61000-4, IEC 62040-2, TUV, VFI-SS-111

4.4.6. Shpërndarja e energjisë për ngarkesat kritike

Furnizimi i Rack-eve duhet të bëhet nëpërmjet shperndaresve te energjise (PDU-ve) 32A të cilat duhet të jenë me matje dhe të menaxhueshme, për të mundësuar monitorimin e konsumit të energjise. Ne çdo Rack duhet të instalohen nga dy PDU të cilat do te furnizohen nga paneli elektrik me kabell 3x6 mm^2.

Shperndaresit e energjise se kabineteve (PDU-të) te menaxhueshme dhe me matje të energjisë, që duhet të instalohen, duhet të sigurojnë optimizimin e energjisë dhe mbrojtje të qarkut, të mund të ulin rrezikun në kohë reale dhe krijojne mundësinë për të paralajmëruar rastet e mbingarkesave të mundshme në qarkun e furnizimit me energji elektrike.

PDU-te duhet të mund te aksesohen dhe konfigurohen nëpërmjet nje Web-i te sigurte, SNMP. Secili Rack duhet të pajiset me nga 2 shperndares energjie (PDU) të menaxhueshme me parametrat e mëposhtëm:

Të dhëna teknike

Tensioni ne dalje

Tensioni Nominal ne Dalje	220V/230V/240V
Rryma Maksimale	32A
Lidhja e daljes	min (15) IEC 320 C13 min (2) IEC 320 C19

Tensioni ne Hyrje

Tensioni Nominal ne hyrje	220V/230V/240V
Frekuenca ne hyrje	50/60 Hz
Lidhja ne hyrje	IEC 309 32A 2P+E
Gjatesia e kabllit	1.5 - 3-meter sipas ambjentit ku do montohet
Numri i kabllove te ushqimit	1
Tensioni i pranueshem ne hyrje	220-240 VAC

Konformiteti

Konform rregullave	CE
Garancia standarte	min. 1 vit

Prizat industriale

Prizat qe do te perdoren per furnizimin e Rack-eve duhet te jene 32A, 230V te tipit industrial dhe me qendrueshmeri te larte ndaj goditjeve mekanike, anti pluhur.

4.4.7. Kanalinat metalike

Sistemi i kanalinave metalike duhet të ndërtohet i tillë që kabllot data dhe të fuqisë të jenë në kanalina të ndara nga njera-tjetra. Kanalinat që do të përdoren për kalimin e kabllove nën dyshemenë teknologjike dhe ne tavan duhet te jene kanalina metalike rrjetë si për kabllot data dhe per kabllot e fuqisë. Kanalinat duhet të montohen poshtë dyshemesë teknologjike në lartësi te ndryshme nga dyshemeja. Çdo dalje nga kjo kanaline duhet të bëhet me tuba fleksibel, ose rigid sipas nevojës e shoqeruar me aksesorët përkatës.

Kanalina që duhet të shërbejë për instalimet elektrike do të jetë gjatë perimetrit të dhomës, kurse kanalina për instalimin e rrjetit të të dhenave duhet të përshkojë perimetrin e Rack-eve. Per te gjithe instalimet e tjera te mundshme, si per prizat elektrike te sherbimit, duhet te perdoret kanalinë plastike ne lartesi 30-40 cm nga dyshemeja teknologjike.

Kanalinat që duhet të përdoren për instalimet tavanore si video-monitorimi (CCTV), zjarr, ndricim etj. duhet të jenë te tipit metalik të galvanizuar, e shoqeruar me aksesoret e nevojshem si pjastrat bashkuese, kapak, si dhe kthesat 90º në plan. Cdo dalje nga kjo kanaline duhet të bëhet me tuba fleksibël, ose rigit sipas nevojës e shoqeruar me aksesorët përkatës.

4.4.8. Kabllot elektrike

Të gjithe tipet e kablloveve që duhet të instalohen duhet te jene me çlirim të pakët të tymrave dhe gazeve toksike LS0H, me izolim gome.

Percjellësat perveç rasteve kur flitet për instalimet ajrore duhet të jenë gjithmonë të mbrojtur dhe të mbuluar mekanikisht. Këto mbrojtje mund të jene: tuba, kalime, tubacione ose gropa në strukturat e ndërtimit etj. Percjellësit e fazës duhet të shënohen në mënyre të njejtë për të gjithë impiantin (ngjyrat e zeze, gri dhe kafe).

Shtrimi i tubave plastik te instalimeve

Instalimet me tuba plastikë shtrihen në të gjithë ambjentet për furnizimin me energji të ndriçueseve, prizave, prizave te telefonise dhe internetit. Kushte te domosdoshme ne lidhje me perdorimin e tubave plastike:

- Duhet te perdoren tuba fleksibel te forte per shtrimet ne mure dhe tavan.
- Nuk duhet te behet tejmbushja e tubave me tela apo kabllo duke respektuar normat elektrike.
- Duhet te instalohen tubacione si dhe kuti shperndarese te ndara per linjat fuqi-ndricim, telefoni-internet, sensore dhe kabëll bus.

Te gjitha lidhjet elektrike qe duhet te behen ne kutite shperndarese duhet te behen me klema elektrike. Nese do te kete me shume se dy kuti shpërndarëse duhet të lidhet gjithmonë një deri në dy tuba rezervë për komunikimin midis tyre. Kutitë shpërndarëse duhet të zgjidhen në madhësinë e duhur pa krijuar ngjeshje dhe ngatërrim të fijeve që bashkohen. Pozicionimi i tyre duhet të bëhet në pozicione sa me pak të dukshme për syrin duke respektuar kushtet dhe normat elektrike që duhen për të punuar dhe operuar në rast shërbimi. Duhet të ruhet rregulli i shtrirjes së tubave duke mos i dhënë kënde të forta. Drejtimi i tubave të instaluar në mure duhet të jetë gjithmonë vertikal ose horizontal. Asnjëherë nuk duhet të ketë tuba ne drejtime diagonal.

4.4.9. Sistemi i Tokëzimit

Duke shfrytezuar tokëzimin ekzistues te godines, në nyjen ekuipotenciale të dhomës së serverave të qendrës së vazhdueshmërisë së biznesit (BCC Site), duhet te lidhen të gjithë përcjellësit e pajisjeve. Gjithashtu duhet të tokëzohen pajisjet metalike të dhomës së serverave, UPS-te, Kondicionerët, Rack-et, dyshemeja teknologjike, etj.

4.5. Infrastruktura Mekanike - Sistem Kondicionimi

Koncepti i ftohjes

Koncepti ftohjes se dhomes se serverave është i bazuar ne sistem me fryrje precize dhe perfshin pajisjet e meposhtme:

- Kondicionere "Precise Cooling" me fryrje te ajrit nga poshte dhe thithje te ajrit nga lart.
- Kondensera te cilat instalohen ne pjesen e jashtme per te shkembyer nxehtesine.
- Tuba bakri te veshur dhe Gas R410A.

Diagrama e pergjithshme e sistemit ftohes

Një nga gjërat më të rëndësishme në dhomën e serverave të qendrës së vazhdueshmërisë së biznesit (BCC Site), eshtë kontrolli i temperaturës në mjedisin e brendshëm, furnizimi me ajër të ftohtë 24/7. Një bashkëveprim i duhur mes ajrit të kondicionuar, ventilimit dhe lagështuesit është më se normale për të lejuar ftohjen e nevojshme.

Një kondicionim i pasaktë, ose me të meta të ajrit në dhomën e serverave mund të shkaktojnë situatat e dëmtimit si dështimi i sistemeve TIK dhe humbjen e të dhënave. Temperatura CPU core sipas AMD nuk mund të kalojë 90°C dmth 70°C mbi sipërfaqe e CPU. Në një temperaturë mbi 60°C në dhomën e serverave hard drive (HDD) janë të shkatërruar plotësisht, ku temperatura në sipërfaqe hard drive (HDD) s'duhet të kalojë mbi 45°C, gjithashtu temperatura mbi 45°C shkatërron plotësisht Power Supplies e pajisjeve hardware.

Sistemi i kondicionimit në dhomën e serverave duhet të plotësojë disa kërkesa si më poshtë:

- Mjedisi brenda Dhomës së Serverave duhet të mbahet rreth temperaturës 21±1°C.
- Alarmet e nevojshme për ndryshimin e temperaturës do të monitorohen në kuadrin e 24x7 dhe duhet te jene te shfrytezueshme për të nxjerë raportime ditore ose mujore.
- Niveli i lageshtise se ambjentit (RH) duhet te mbahet ne 45% ± 5 pa-kondesim.
- Duhet te monitorohen alarmet e nevojshme per ndryshimin e lageshtise se ambjenitit (RH)
- Dizenjimi i Rack-eve duhet te permbushe konceptin e ngrohjes dhe ftohjes sipas korridoreve.

Dhoma e serverave e qendrës së vazhdueshmërisë së biznesit (BCC Site) do te jetë me 6 Rack-ë dhe per kete kapacitet eshte menduar se jane te nevojshme të instalohen 2 njësi kondicionimi min. 34 kW secila, duke siguruar redundance 2N.

Nje shembull i konceptit te ajrit te ngrohte dhe te ftohte sipas rreshtave jepet si me poshte:



Diagrama e pergjithshme e sistemit te ftohjes - Parimi i sistemit te kondicionimit me fryrje ajri nga poshte "down flow"

Te dhena teknike per sistemin e kondicionimit ne dhomen e serverave
Te pergjithshme
Njesia automatikisht duhet te monitoroje dhe kontrolloje nxehtesine, ftohjen, lageshitren, tharjen, funksionimin e filtrave. Per kushtet e hapesires qe do te operoje sistemi duhet te jete i montueshem ne dysheme edhe i konfiguruar per fryrje te ajrit nga poshte.

Elementet e meposhtem jane te detyrueshem per sistemin e kondicionimit ne dhomen e serverave:

- Të ketë komunikim mes njësive për redundancë.
- Fryrje e ajrit nga poshtë.
- Fuqi ftohëse totale e llogaritur ne temperature te jashtme 35º min. 34 kW
- Niveli i ndjeshmerise se nxehtesise (SHR) min 80%
- Kapaciteti total ne ftohje (Net total cooling capacity) min 26 kW
- Temperatura e ajrit të dërguar max. 15 °C
- Fryrja e ajrit nga njesia e brendshme te pakten 8000 m^3h.
- Fuqia e njesise 3 fazore, 50 hz.
- Numri i qarqeve ftohese 1
- Lloji i lagështuesit me elektroda të zhytura
- Te jete e pajisur me thares elektrik
- Të ketë dalje rele, për tu lidhur me kontrollin e panelit të alarmit për të transmetuar të gjithë alarmet

Struktura e njesise
Ndertimi i kabinetit edhe kornizes duhet te kete karakteristikat e meposhtme:

- Struktura e pajisjes duhet te jete nje kornize metalike e jashtme dhe pjeset e brendshme te struktures te jene te perbera nga zinku edhe celiku.

- Njesia duhet te jete e dizenjuar me nje fasade te dyte per presionin nen dysheme te rrjedhjes se ajrit, kur nje panel i jashtem eshte hequr per servis ose mirembajtje. Panelet e ndermjetme duhet te jene te segmentuar per secilen pjese te njesise (nje panel dytesor per te aksesuar filtrat, seksionin e faneve, spiralet etj). Gjithashtu edhe per te minimizuar rrjedhjen e ajrit kur paneli eshte i hapur.
- Paneli i jashtem duhet te jete i lyer me boje epoxy-poliester. Panelet perpara duhet te jene te ngjitur me kuadratin me ane te kapseve. Paneli nga jashte duhet te jete me dopjo cope kurse nga brenda me material fiber-qelq izolues nxehtesie.

Filtrat e kthimit te ajrit

- Filtrat e ajrit te jene sipas standarteve, te montuar ne kase metalike.
- Nderrimi i filtrave te behet nga pjesa e perparme e njesise.

Mikroprocesori kontrollues

1. Kontrolli duhet te perfshije:

    - Bordi i kontrollit te mikroprocesorit te jete vendosur brenda panelit elektrik, i ndare nga njesia e rrjedhjes se ajrit.
    - Te kete nderfaqe te thjeshte per perdoruesit
2. Bordi i kontrollit te mikroprocesorit duhet te permbaje te dhena dhe program te te gjithe parametrave te ruajtur te cilat duhet te jene te dukshme ne nderfaqen e perdoruesit.
3. Nderfaqja e Perdoruesit duhet te jete e mbrojtur me password.
4. Nderfaqja e Perdoruesit duhet te lejoje modifikimin edhe rregullimin e parametrave.

Kontrolli i Funksionimit te Sistemit

1. Sinjalizimi i alarmeve lokalisht dhe ne distance (remote).
2. Regjistrimi i te gjitha alarmeve edhe mbajtja e tyre per minimumin e 100 ngjarjeve te fundit.
3. Rindezje automatike pasi energjia rikthehet.
4. Komandim ne distance te njesise on/off
5. 2 nivele (te dhena dhe servise)
6. Mundesia per te komunikuar me nje sistem supervizimi me nje kabell etherneti ne BACNet IP ose SNMP ose Modbus IP ose TCP/IP.
7. Funksionimi Ore/Date
8. Llogaritja e oreve vepruese dhe fillimin e cikleve te komponenteve kryesore.

Të ofrojë mundesi për perzgjedhje të gjuhës minimumi

1. (EN = English, DE = German, FR = French)

EKRANI

- Statusi i ekranit. Ndërfaqja e perdoruesit te parazgjedhur duhet te shfaqe:
    - Kohen, daten dhe numrin e njesive ne rrjetin lokal LAN
    - Temperaturen e dhomes dhe lageshtiren relative
    - Statusin e njesise
    - Simbol fleshimi ku tregon qe njesia eshte ne progres
    - Statusin qe tregon qe ventilatori eshte ne pune

- Te dhenat e ores
  - Mikroprocesori i njesise duhet te perfshij nje karte per oren qe do te mirembaje edhe shfaq daten oren dhe ditet e javes.

Kontrolli manual

- Per te ndihmuar mirembajtjen dhe kontrollet ose ne raste emergjence, perberesit e meposhtem individual mund te aktivizohen me dore edhe ne menyre te pavarur nga proceset e kontrollit.
  - Njesia ventilatoreve, faneve (Unit start-Up)
  - Kompresoret 1/2/3/4 (e aplikueshme)
  - Funksioni i dehumidifikimit (e aplikueshme)
  - Ngrohesit elektrik (te aplikueshme)
  - Aktivizimi 0/1 daljeve analoge ne DX (Y0/Y1Ramp)

Kondicioneri duhet te jete me levizje rrethore "Scroll Compressor".
"Scroll compressors" te kene karakteristikat e meposhteme:

- Instalimi i suporteve antivibrim
- Kompresori duhet te jete i instaluar ne nje zone te dedikuar mekanike te ndare nga njesia e rrjedhjes se ajrit per qasje gjate operacionit te njesise me percarje minimale te rrjedhjes se ajrit ose te presionit statik nen dyshemen teknologjike.

Kondenseri i ftohjes se ajrit

- Temperatura per funksionimi normal ne ambientin e kondenserit eshte 35 grade celcius dhe temperatura e larte arin deri ne 46 grade celcius, kondenseri per levizjen e ajrit te ftohte mund te jete me 1 ose 2 qarqe ftohese me tuba bakri te zgjerueshem, flete alumini me ventilatore aksial me shpejtesi te ulet. Kondenseri te jete i galvanizuar, prej celiku dhe te mbuluar me boje epoxy. Kondesatoret ne distance te kene te perfshire pjesen e mbrojtjes kundra ujit per panelin elektrik. Secili ventilator do te jete i pajisur me rrjete celiku per mbrojtjen nga pjese mekanike qe mund ta demtojne.
- Menaxhimi i ventilatoreve (faneve) duhet te jete i moduluar me faza te prera qe rregullojne uljen e temperatures.

Rele per kontrollin nga larg per zjarrin edhe sensorin e tymit

- Sistemi duhet te jete i pajisur me rele 24V ne panelin kryesor te kontrollit per lidhjen ne distance per sensorin e tymit ose sensorin e zjarrit. Ndryshimi i gjendjes se relese fik njesine edhe siguron alarm vizual dhe zanor ne terminalin e perdoruesit.

Pajisja ftohese duhet te jete e pajisur me nderfaqe (adaptor) serial TCP/IP ose RS485 ose RS232 duke mundesuar komunikimin me ane te protokollit TCP/IP ose BACNet IP ose Modbus ose SNMP.

4.6. Pajisejet IT Pasive

4.6.1. RACK-et

Rack-et kerkohet te jene te tipit 42U permasa minimalisht 800 mm Gjeresi x 1200 mm Thellesi. Pozicionimi i rack-eve ne dhome duhet te jete i tille qe te lejoje sherbimin ndaj rackeve dhe pajisjeve te instaluara ne to si ne pjesen e perparme, ashtu edhe ne ate te mbrapme.

Aksesoret dhe Instalimi:
Rack-u duhet te siguroje 42U hapesire vertikale. Shinat vertikale duhet te jene lehtesisht te rregullueshme per te lejuar thellesi te ndryshme. Çdo shine vertikale duhet te jete e shenuar ne te dyja anet me linjat qe tregojne fillimin dhe ne fund te çdo U dhe numrin e hapesires U. Te dy dyert (para dhe pas rack-ut) duhet te jene te dizajnuara me mentesha per heqje te shpejte te dyerve pa perdorur vegla. Dyert para dhe mbrapa duhet te hapen nje minimum prej 120 grade per te lejuar akses te lehte ne pjesen e brendshme. Rack-u duhet te perfshije panele anesore gjysme-lartesi qe mund te hiqen pa perdorur vegla. Panelet anesore duhet te jene te rrafsheta me Rack-un keshtu qe gjeresia e pergjithshme e njesise nuk do te ndryshoje me panele anesore te instaluara. Te gjitha komponentet e Rack-ut te tilla si dyer, panele anesore, çati, etj. duhet te lidhen direkt ne kuader. Gjithashtu duhet te sigurohen pika te cilat mundesojne tokezimin e Rack-ut.
Rack-u duhet te kete dyer te cilat krijojne mundesi per ventilim ne pjesen para / pas / lart etj si dhe duhet te mundesoje hapje nga siper dhe poshte per te menaxhuar kabllot ne Rack.

Siguria
Rack-u duhet te perfshije brave per mbyllje nga perpara dhe mbrapa te cilat duhet te jene te konfiguruara qe te perdoren me te njejtin çeles.

Te dhenat teknike
Rack 800 x 1200

Parametrat e Rack IT	
Gjeresia:	800 mm
Lartesia:	42U
Thellesia:	1200 mm
Dyer perpara dhe pas:	E biruar
IP rating:	IP20
Peshembajtja statike:	min. 1000 kg
Peshembajtja dynamike:	min. 450 kg
Ngjyra:	e zeze

Aksesore per Rack

Po ashtu duhet te perfshihen te gjithe aksesoret e nevojshem per instalime ne Rack-e. Nder to duhet te instalohen edhe menaxhuesit e ajrit.

Menaxhuesit e ajrit

Duhet te perdoren menaxhues per ajrin, ne menyre qe te kete ftohje sa me optimale te pajisve IT

qe dote instalohen neper Rack-e. Keto menaxhues duhet te jene pjese e aksesoreve te Rack-eve ne dhomen e serverave. Duhet te perdoren menaxhuesit e ajrit ne menyre qe te mbulohen hapesirat boshe neper te gjithe Rack-et me lartesi 1U ose 2U ose 3U ose 5U ose 10U. Ngjyra: e zeze.

4.6.2. Sistemi i Network

Rrjeti data është i nevojshëm për të bërë të mundur komunikimin midis pajisjeve me njëra tjetrën. Duhet të bëhet kabllimi në dhomën e serverave me anë të kabllove të transmetimit data bakër si edhe fibër optike. Kërkohet që për kabllimin me anë të bakrit të përdoret kabëll Cat. 6A FTP LSZH, ndërsa për fibrën optike kërkohet që të përdoret fibër Multimode OM4 LSZH. Si kabllot e bakrit ashtu edhe kabllot e fibrës kërkohet që të jenë të paraterminuar, përkatësisht me konektorë RJ45 për kabllot e bakrit dhe konektorë LC për fibrën optike Multimode të terminuar në patch panel.

4.6.2.1. Rrjeti i Bakrit

Rack-et që do të instalohen në dhomën e serverave duhet të komunikojnë me njëri tjetrin me anë të rrjetit data bakër Cat 6A FTP LSZH.

Komunikimi me ane te rrjetit baker Cat 6A, FTP, LSZH, i para-terminuar me konektore RJ45-RJ45:

- Nga Rack i agregimit, R1 duhet të nisen në secilët nga Rack-et e tjerë nga R2 në R6 nga nje tufe me nga 6 kabllo bakër.
- Kabllot e bakrit duhet të terminojnë në panel-et e bakrit me nga 24 porta, të cilët duhet të instalohen në secilin nga Rack-et sipas zgjidhjes se ofruar nga operatori.
- Gjithashtu, për menaxhimin e kabllove duhet të përdoren menaxhues kabllosh minimalisht 1U.

Patch Panel Modular për Ethernet RJ45

Për terminimin e kabllove Ethernet në Rack duhet të montohen patch panele me kapacitet minimal 24 porta, të cilët duhet të jenë modular për tu populluar sipas nevojave. Karakteristikat teknike të tyre mund të përmblidhen si më poshtë:

1. Tipi: Patch PanelModular 1U, 19”
2. Karakteristika: Modulare 2x12 porta, ose 3x8 porta, ose 4x6 porta.
3. Materiali: prej çeliku të zinkuar.
4. Kapaciteti: Minimumi 24 porta RJ45.
5. Mbrojtja: Hapësirat pa module duhet të jenë të mbrojtura.
6. Lloji i kabllimit që suporton: kabull të skermuar ose jo.
7. Instalimi: i thjeshtë bazuar në teknikat ngjeshjes, (snap and go).
8. Tokëzimi: Të jetë i pajisur me elementë të cilët sigurojnë tokëzimin e kabllove.
9. Etiketimi: Të ketë mundësi për instalimin e etiketave si edhe përdorimin e kodit të ngjyrave.

Kabllot Bakër të Para Terminuar

Sikurse e kemi theksuar edhe më sipër kabllot e Bakrit Ethernet duhet të jenë të para-përgatitur në gjatësitë e duhura në fabrikë dhe duhet të jenë të paraterminuara me koka RJ45 Cat. 6A. Karakteristikat teknike të tyre mund të përmblidhen si më poshtë:

1. Tipi i Kabllit: Kabllo të paraterminuara me konektorë RJ 45 të kategorisë Cat.6A ISO
   të skermuar.
2. Materiali: Bakër, Twisted Pair, i skermuar (S/FTP), Cat.6A
3. Karakteristika e kabllit: Kabëll 6x4 çifte (pair), zjarr durues, pa halogjen LSZH/LS0H

Gjatësitë e kabllove per lidhjen midis Rack-eve:

- Pre-term x6 RJ45 – RJ45 Cat 6A LSZH F/FTP R1-R2 → 9 ml
- Pre-term x6 RJ45 – RJ45 Cat 6A LSZH F/FTP R1-R3 → 7 ml
- Pre-term x6 RJ45 – RJ45 Cat 6A LSZH F/FTP R1-R4 → 10 ml
- Pre-term x6 RJ45 – RJ45 Cat 6A LSZH F/FTP R1-R5 → 8 ml
- Pre-term x6 RJ45 – RJ45 Cat 6A LSZH F/FTP R1-R6 → 11 ml

Shenim: Te gjitha gjatesite e mesiperme te kabllove jane llogaritur referuar planimetrise ilustruese ne Fig.1. Kontraktori eshte pergjegjes per percaktimin e gjatesive te sakta te kabllove ne varesi te zgjidhjes qe do ofertoje.

4.6.2.2. **Rrjeti i Fibrës Optike**

Rack-et që do të instalohen në dhomën e serverave duhet të komunikojnë me njëri tjetrin me anë të rrjetit data fiber optike Multimode OM4 LSZH.

Instalimi i fibrës optike Multimode kërkohet të bëhet si më poshtë:

- Nga Rack i agregimit R1 duhet të nisen drejt Rack-eve R2 deri në R6 nga 1 tufë me nga 8 fije fibër optike Multimode OM4, të paraterminuara nga të dy anët me konektorë LC – LC.
- Për terminimin e fibrave duhet të përdoren patch panel-e fibre me nga 24 porta LC duplex të pajisur me adaptorë Multimode LC duplex te nevojshem për instalimin e fibrës Multimode OM4.
- Gjithashtu, për menaxhimin e kabllove duhet të përdoren menaxhues kabllosh minimalisht 1U.

Patch Panel Modular për Fibër dhe adaptoret LC

Për terminimin e kabllove të fibrës në Rack duhet të montohen patch panele me kapacitet deri në 24 porta LC Duplex-e, në të cilët duhet te montohen konektorët LC Duplex per nevojen e instalimit te fibres Multimode. Karakteristikat teknike të tyre mund të përmblidhen si më poshtë:

- Tipi: Patch Panel Modular 1U, 19”
- Materiali: prej çeliku të zinkuar.
- Kapaciteti: Maksimumi 24 porta LC-Duplex.
- Mbrojtja: Hapësirat pa module duhet të jenë të mbrojtura.

- Modulet: Të tipit LC-Duplex Multimode
- Instalimi: I thjeshtë bazuar në teknikat ngjeshjes, (snap and go).
- Etiketimi: Të ketë mundësi për instalimin e etiketave si edhe përdorimin e kodit të ngjyrave.

Adaptoret LC

Ne patch panelet e fibres duhet te instalohen adaptoret LC duplex Multimode per instalimin e fibres optike Multimode te para-terminuar.

Kabllot Fibër të Para-Terminuar

Sikurse e kemi theksuar edhe më sipër kabllot e Fibrës Optike (FO) duhet të jenë të para përgatitur në gjatësitë e duhura në fabrikë dhe duhet të jenë të paraterminuara me koka LC. Karakteristikat teknike të tyre mund të përmblidhen si më poshtë:

- Fire/Flame retardant;
- Tipi i Kabllit: Fibër Optike Multimode OM4 (FO MM OM4) me 8 fije
- Rezistent ndaj ujit dhe kundër brejtësve

Gjatësitë e kabllove MM per lidhjen midis Rack-eve:

- Pre-term x8 LC – x8 LC OM4 from/to (R1:R2) → 9 ml
- Pre-term x8 LC – x8 LC OM4 from /to (R1:R3) → 7 ml
- Pre-term x8 LC – x8 LC OM4 from /to (R1:R4) → 10 ml
- Pre-term x8 LC – x8 LC OM4 from /to (R1:R5) → 8 ml
- Pre-term x8 LC – x8 LC OM4 from /to (R1:R6) → 11 ml

Shenim: Te gjitha gjatesite e mesiperme te kabllove jane llogaritur referuar planimetrise ne Fig. 1. Kontraktori eshte pergjegjes per percaktimin e gjatesive te sakta te kabllove ne varesi te zgjidhjes qe do ofertoje.

4.6.2.3. Menaxhuesit e Kabllove

Menaxhuesit e kabllove horizontale - specifikime

Per menaxhimin e kabllove, per çdo patch panel te instaluar duhet te instalohet nga nje menaxhues kabllosh (patch guide) horizontale 1U.

- E pershtatshme per menaxhimin e kabllove Fiber Optike dhe Baker.
- Ngjyra: e zeze.

Menaxhuesit e kabllove vertikale – specifikime

Per menaxhim sa me te mire te kabllove neper Rack-e me gjeresi 800 mm, perveç menaxhuesve

horizontal te kabllove 1U, duhet te perdoren gjithashtu edhe menaxhues vertikal te kabllove (nga 2 per secilin Rack, ne pjesen perpara).
Dimensionet minimale: 10 x 11 cm (Gjeresi x Thellesi)
- Tipi: kreher
- Ngjyra: e zeze

4.6.2.4. **Kanalina e Verdhë**

Per menaxhimin ne menyre te sigurte te kabllove fiber optike mbi Rack-e, duhet te perdoret kanaline e verdhe, e cila duhet te instalohet siper Rack-eve. Kanalina e verdhe duhet te jete pa Halogjen, ne perputhje me UL 94 V-0.

Kanalina e verdhe duhet lejoje qe te behet kabllimi me fiber optike ndermjet pajisjeve te ndryshme duke siguruar mbrojtje fizike si dhe mbrojtje ne performance duke mos lejuar perthyerjen e kabllove.
Te perdoren aksesoret e nevojshem per instalimin e kanalines se verdhe (bashkues, zbrites, kapake, mbyllese etj.).

Kanalina kryesore

- Te kete gjatesi standrate minimalisht 2m dhe te kete mundesine e bashkimit me pjese te tjera me ane te bashkuesve.
- Te kete mundesine te pritet dhe te perdoret per gjatesi me te vogla nga gjatesia standarte.
- Ngarkesa minimale 18kg/m
- Ngjyra: e verdhe

Bashkuesi
- Duhet te perdoret per te lidhur komponente te kanalines se verdhe
- Mos te jete nevoja per shpim te kanalines apo te komponenteve te tjere
- Ngjyra: e verdhe

Kendet
- Duhet te perdoren per kthimin e kanalines se verdhe ne kend 90°
- Kerkohen nga dy bashkues per çdo aksesor kendi ne menyre qe te behet kithimi i kanalines ne 90°
- Ngjyra: e verdhe

Zbrites
- Te perdoret per zbritjen e fibres nga kanalina e verdhe ne Rack.
- Ngjyra: e verdhe

4.7. Sistemi i Detektimit dhe Fikjes së Zjarrit

Sistemi i detektimit te zjarrit

Dhoma e serverave duhet që të pajiset me sistem detektimi dhe sinjalizimi të zjarrit per te gjithe hapesiren (si per hapesiren e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe tavani, ashtu edhe per hapesiren e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe dyshemeja fikse. Pajisjet e alarmit të zjarrit duhet të instalohen sipas rregullave dhe standarteve lokale. Për detektimin e zjarrit duhet të vendosen në dhomën e serverave detektorë temperature dhe detektorë optikë tymi. Për sinjalizimin e alarmit të zjarrit duhet te vendosen sirena. Ky sistem duhet të ketë aftësi per t'u integruar me sistemet e tjera.
Sasia dhe vendosja ne planimetri e cdo komponenti (sensore, detektore, sirena, panel kotrolli, bombula etj) te sistemit te detektimit dhe shuarjes se zjarrit, duhet te percaktohet nga operatori ekonomik ne varesi te zgjidhje qe do te ofertoje. Ne paragrafet e meposhtem paraqiten specifikimet teknike minimale dhe komponentet qe duhet te perfshije ky sistem. Kerkohet qe te gjithe komponentet te instalohen dhe konfigurohen ne varesi te zgjidhjes se ofruar sipas manualeve te prodhuesve.

Sistemi i fikjes se zjarrit
Sistemi duhet të bazohet në një panel kontrolli kryesor të pavarur dhe me burim ushqimi nga bateria në rast të shkeputjeve të energjisë. Sistemi duhet të jetë i pajisur me pajisje sinjalizuese alarmi të dëgjueshme dhe të shikueshme të cilet duhet te montohen jashtë dhomave të monitoruara. Butoni i aktivizimi dhe çaktivizimit të alarmit duhet te montohet brenda dhomës së serverave. Nje sinjalistike per alarmin e zjarrit (psh. "Stop Gaz") gjithashtu duhet të montohet në hyrje të derës se dhomës së serverave.
Duke qenë se në këto ambjente akomodohen pajisje elektrike dhe elektronike, si agjent për shuarjen e zjarrit duhet të perdoret gaz NOVEC ose ekuivalent (me perjashtim te gazrave jo te paster dhe imitime), i cili ruhet ne cilindra ne temperature dhome ne gjendje te lenget dhe shkarkohet ne ambjent ne momentin e aktivizimit si gaz.

Sistemi duhet të jetë i programuar për këto skenarë:

Stand by - Sistemi është në gatishmeri.
Në këtë gjendje sistemi nuk kryen asnjë veprim por vetëm lexon të dhënat nga detektoret e zjarrit në zonat e përcaktuara më lart.

Prealarm – (**Pre-activated**) Sistemi ka sinjal alarmi (**Fire Alarm**) nga një prej zonave të mbulimit të zjarrit (kur aktivizohet një sensor në zonën e mbrojtur nga zjarri-temperature ose tym) dhe duhet të iniciojë një alarm në panelin e kontrollit, duhet të aktivizojë sirenat dhe dritat pulsuese në zonën e mbuluar nga ky sensor. Këto sinjale i dergohen dhe personelit për kontrollin dhe monitorimin e mbrojtjes nga zjarri.
Në këtë gjendje nuk duhet të aktivizohet menjëherë sistemi i shuarrjes së zjarrit për të shmangur alarmet "false", qe mund te vijne si rezultat i faulteve te sitemit. Pas ndërhyrjes së operatorëve të sigurisë, në rastin e alarmeve "false", sistemi mund të kthehet në gjendjen e tij normale nëpërmjet butonave të komandimit në panelin e kontrollit.

Alarm – (**Activated**) Sistemi ka sinjal alarmi nga të dy zonat e dhomes (sensore temperature dhe detektor tymi). Detektimi i zjarrit nga një sensori i dytë aktivizon "alarmin nga zjarri" dhe kalimin në fazën e shuarjes së zjarrit; edhe në këtë fazë, operatorët mund të ndalojnë manualisht kalimin në procesin e shuarjes së zjarrit (në rast se zjarri mund te shuhet nëpërmjet shuarësve portabël me pluhur ose nëse kemi të bëjmë me një alarm "fals"). Sistemi i projektuar i mbrojtjes nga zjarri duhet t'i mundësojë

operatorëve edhe aktivizimin manual në procesin e shuarjes së zjarrit nëpërmjet butonit përkatës në ambjent. Në këtë gjendje sistemi jep alarmin per evakuimin e ambjenteve duke ndezur sinjalet dalje dhe duke aktivizuar alarmin e përgjithshem. Njëkohesisht behet caktivizimi i magneteve te dyerve nga sistemi i kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit.
Pas një kohe relativisht të shkurtër (e cila duhet të përcaktohet nga administratori i sistemit) kohë e mjaftueshme për evakuimin e personelit, nëse ka, behet aktivizimi i paisjes për fikjen e zjarrit.
Pas aktivizimit të fazes së shuarjes së zjarrit dhe shuarjes së tij dhe para se personeli të futet përsëri në ambjentet ku është gjeneruar gazi duhet të kryhet ajrimi i detyruar i ambjentit, në të cilat është aktivizuar sistemi i mbrojtjes nga zjarri, për të evituar dëmtimin shëndetësor të personelit.

Sistemi i dedektimit dhe shuarjes se zjarrit duhet te kete komponentet e meposhtem:

- Paneli i Kontrollit
- Detektoret e tymit dhe te temperatures
- Cilinder me agjentin e shuarjes
- Pajisjet e Sinjalizimit (Alarmit- Sirena/Beacon/ sinjalizues me drite/ audio etj ne varesi te zgjidhjes se ofertuar)
- Butonat e Aktivizimit dhe Ndalimit Manual - ne varesi te zgjidhjes se ofertuar mund te jete 1 buton me funksione te kombinuara/2 butona me nga nje funksion/ zgjidhje tjeter qe nuk cenon funksionalitetin e kerkuar dhe specifikimet e ketij sistemi
- Tubat dhe nozolat e shkarkimit – kerkohet te instalohen minimalisht 2 nozola per shkarkim ne dy ambientet (mbi dyshemene teknologjike dhe nen dysheme teknologjike). Gjatesia e tubave edhe elementet si kthesat, brrylat, bashkueset etj si edhe seksioni i tubave varet nga zgjidhja e ofertuar sipas simulimit me software nga prodhuesi

Paneli i kontrollit – 1 cope
Nga pikepamja llogjike ky panel duhet te jete i ndare ne zonen e hyrjeve (mbledhja e sinjaleve hyrese nga dedektore ose butona qe aktivizojne nje alarm), dhe ne zonen e daljeve (gjenerimi i sinjaleve nepermjet sirenave te alarmit dhe aktivizimi i shuarjes).
Paneli i kontrollit duhet të jetë i pozicionuar ngjitur me hyrjen kryesore ose brenda dhomës së serverave. Aktivizimi i lëndës shuarëse mund të konfigurohet për të aktivizuar nga çdo kombinim i inputeve të zonave te mbulimit.
Paneli duhet të ketë bateri backup për të siguruar vazhdimësinë e funksionit të tij edhe në rast se mungon energjia kryesore e tij.

Dedektor Tymi & Temperature
Te kene shperndarje te tille qe te mbulojne te gjithe hapesiren e dhomes se serverave. Te jene ne perputhje te plote me sistemin e panelit te kontrollit. Kerkohet te instalohen minimalisht 6 detektore tymi edhe 6 detektor temperature.

Sirena

Duhet te perdoret nje sirene me sinjalizues (autoparlant dhe/ose tabele sinjalizimi) ne hyrje te dhomes se serverave ku duhet te implementohet ky sistem. Sirena duhet te jete ne perputhje te plote me sistemin e panelit te kontrollit. Nese per instalimet e dedektoreve nevojitet perdorimi i lidhjeve dhe instalimeve kabllore, atehere Operatori Ekonomik do te jete pergjegjes per lidhjen e dedektoreve me kabell. Sasia e kabllit edhe cdo element tjeter i zgjidhjes do te percaktohet nga OE ne baze te zgjidhjes se simuluar.

Extinguishant Release Control

Duhet të jepet mundësia për clirimin e agjentit shuarës të zjarrit manualisht me anë të një switch të veçantë (një Button Push ose ekuivalent).

Butonat e Aktivizimit dhe Ndalimit Manual

Ne hyrjen e dhomes se serverave, jashte dhome, duhet te montohen butonat e Aktivizimit Manual dhe te Ndalimit Manual te sistemit te shuarjes.

Butoni i Aktivizimit manual

Mund te perdoret nese kerkohet aktivizim i menjehershem i sistemit te shuarjes (ne rast se vetem njeri nga dedektoret eshte aktivizuar dhe paneli ka kaluar ne gjendjen "Pre-alarm", personeli pergjegjes mund te shtype kete buton dhe te aktivizoje manualisht sistemin e shuarjes).

Butoni i Ndalimit (ose vonimit) te aktivizimit

Mund te perdoret ne rastet kur paneli ka kaluar ne gjendje "Alarm", por duam te vonojme ose ndalojme aktivizimin e sistemit te shuarjes pasi personeli pergjegjes veren se eshte alarm fals ose ne dhome ka rene zjarr qe mund te shuhet ne menyra te tjera (psh. me nje fikse dore).

Butonat duhet te jene ne perputhje te plote me sistemin e panelit te kontrollit.

Cilindri me agjent shuares

a) Cilindri duhet te kete perberje celiku. Çdo cilindër që mund të instalohet duhet të testohet presioni në një presion provë me te lartë se presioni i punës. Permasat e cilindrit edhe sasia e agjentit shuares duhet jete llogaritur konform vellimit te dhomes (referuar permasave te dhomes)
b) Cilindri duhet te respektoje normat e percaktuara ne NFPA2001 (National Fire Protection Association)
c) Cilindri duhet të montohet dhe të lidhet në mënyrë të sigurtë.
d) Kerkohet që mbi cilindër të shënohen informacione si psh:
    i) Kapaciteti Volume (lt) dhe dendësia e mbushjes
    ii) Pesha neto (kg) e cilindrit.
    iii) Sasia e shuarjen që përmban (Kg)
    iv) Pesha bruto (kg)
    v) Presioni maksimal i lejuar.

Valvula e Shkarkimit
Valvula e cilindrit duhet te mundesoje rrjedhje te shpejte, qe ne rast aktivizimi te alarmit te beje te mundur shkarkimin e cilindrit ne me pak se 15 sekonda. Valvula e cilindrit duhet te mundesoje aktivizimin me ane te lidhjes elektrike, me aktivizues pneumatik, ose manual duke ushtruar presion mbi pistonin e cilindrit.
Sprucatorët e gazit në dalje
Sprucatorët e daljes së gazit duhet të jenë prej alumini per te parandaluar korredimin. Duhet të jenë nga i njejti prodhues me atë të fikjes së zjarrit me gas.

Agjenti Shuarës

- Agjenti Shuares duhet te jete i paster (Novec ose ekuivalent, por ne asnje menyre nuk duhen perdorur kopje te tyre dhe gaze jo te paster) - avullon shpejt dhe pa lene mbetje, nuk demton paisjet elektronike.
- Duhet të mos shkaktoje dëmtime anësore ne ambjent ne rast clirimi (te siguroje mbrojtjen e pajisjeve elektronike)
- Duhet të jetë projektuar volumetrik
- Instalimet duhet te behen ne perputhje me rekomandimet dhe standardet e prodhuesit.
- Ne fund te instalimit personeli pergjegjes per Dhomen e Serverave duhet te trajnohet per perdorimin e sistemit.
- Projekti i sistemit me agjentin shuares te ofruar ne zgjidhje duhet të jete testuar/simuluar nga një software i certifikuar nga vete prodhuesi. Pas implementimit dhe testimit te sistemit, keto dokumenta duhet ti dorezohen autoritetit.
- Studimi (projekti) i kryer me software nga prodhuesi duhet te dorezohen se bashku me planvendosjen e komponenteve ne dhomen e serverave ne zgjidhjen e propozuar

4.8. Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit

Qëllimi është ndërtimi i një sistemi monitorimi, menaxhimi, kontrolli dhe ndërveprimi të unifikuar. Operatori duhet që nga një ekran te aksesoje njesine kryesore te sistemit te menaxhimit dhe monitorimit dhe të monitoroje punën e të gjithë nensistemeve që do të integrohen në kete sitsem. Sistemi gjithashtu duhet të ofrojë mundësinë e zgjerimit ne te ardhmen.
Përshkrimi i sistemit
Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit të dhomes se serverave të qendrës së vazhdueshmërisë së biznesit (BCC Site), është një sistem kontrolli kompjuterik i cili kontrollon dhe monitoron pajisjet mekanike dhe elektrike të ndërtesës ku instalohet. Ne te njejten menyre, duke u instaluar ne nje dhome serverash, ky sistem shfrytezohet dhe sherben per monitorimin, kontrollin dhe menaxhimin e sistemeve te instaluara ne server room te integruara në një konsole të vetme. Nepermjet sistemit te monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit, kontrolli i sistemeve behet jo vetem me i lehte per tu menaxhuar, por ofron mundesine per te komanduar keto sisteme ne distance. Per garantimin e mirefunksionimit te secilit sistem te integruar ne te, duhet te mundesohet mbledhja e informacioneve dhe sinjalizimeve nga sistemet, dhe menaxhimi i ketyre sistemeve (fikje/ndezje etj) ne varesi te sinjaleve hyrese.
Sistemi duhet qe te jete ne gjendje qe ne rastin e detektimit te rrjedhjes se ujit te bllokoje furnizimin me uje. Po ashtu duhet qe ne rast te detektimit te zjarrit te behet e mundur fikja e sistemit te kondicionimit. Ndersa ne rast se sistemi i zjarrit arrin ne fazen e leshimit te agjentit shuares te behet e mundur hapja ne menyre automatike e deres se dhomes.

Karakteristikat kryesore te sistemit

Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit duhet te kete minimalisht 60 porta hyrese dixhitale te cilat do te sherbejne per te marre informacion nga sinjalet diskrete ne sistem. Numri i portave hyrese dixhitale te sistemit duhet te jete i mjaftushem per te mare informacion mbi gjendjen e te gjithe elementeve te panelit elektrik (automate, rele tensioni, shkarkues mbitensionesh, etj), informacion nga sensoret e dedektimit te ujit, informacion nga centrali i dedektimit se zjarrit, etj.

Sistemi duhet te mundesoje minimalisht 10 porta hyrese analoge te cilat do te sherbejne per te marre informacion nga sinjalet analoge qe do te gjenerohen nga sensoret e temperatures dhe te lageshtise qe do te instalohen ne dhome.

Per te te bere te mundur komandimin e elektrovalvules, fikjes se kondicionereve etj, duhet qe sistemi te kete minimalisht 10 porta dalese dixhitale.

Ne rast se per integrimin e sistemeve te kerkuara ne BMS do te perdoret protokoll komunikimi modbus, sistemi i monitorimit duhet te kete porte komunikimi modbus ose minimalisht nje kovertues nga modbus ne TCP IP i cili do te sherbeje per te marre informacionet e envojshme nga keto paisje.

Ne dhomen e serverave te vazhdueshmerisese biznesit (BCC site) duhet te instalohen minimalisht 1 sensor temperature, 1 sensor per dedektimin e rrjedhjes se ujit, 1 sensor temperature/lageshtire, per te marre informacionet e nevojshme per te mbajtur nen kontroll parametrat ambientale te dhomes nepermjet monitorimit nga BMS pa perfshire ato qe do te vendosen nen dyshemene teknike dhe Rack-e.

Sistemi duhet te ofroje dhe mundesine e dergimit te mesazheve nepermjet SMS, ndaj per te arritur kete qellim duhet qe sistemi te suportoje lidhjen me 1 pajisje GSM.

Sistemet që duhet të monitorohen dhe integrohen ne sistemin e monitorimit dhe menaxhimit janë:

- **UPS**

Këto pajisje duhet të kenë karta komunikimi modbus ose TCP/IP nga ku duhet të merret informacioni mbi:

- Nivelin e ngarkesës
- Kohëzgjatja e furnizimit nga bateria në varësi të ngarkesës.
- Statuset e punës së UPS-së (nga linja e pare e furnizimit, nga linja e dyte e furnizimit, nga baterite, bypass).
- Parametrat e energjise ne hyrje-dalje te pajisjes.
- Kohen kur duhet te meren masa nese pjeset e brendshme te pajisjes jane amortizuar dhe duhen nderuar.
- Alarmet e ndryshme në lidhje me punën e UPS-së.
- Historikun e eventeve
- Informacioni duhet të ruhet për një periudhë kohe 3 mujore, etj.

Për secilin nga funksionet që bien në alarm, sistemi duhet të raportojë me ane te SMS, e-mail ose me thirrje me ze (voice call), sipas prioritetit të alarmit.

- **Kondicionim**

Këto pajisje duhet të kenë karta komunikimi modbus nga ku duhet të merret informacioni mbi:

- Nivelin e temperaturës.
- Nivelin e lagështirës relative.
- Nivelin e larte te presionit ne qarkun ftohes.

- Gjendjen e filtrave
- Mungesen ose tepricen e ujit ne lageshtues
- Oret e punes se njesise
- Oret e punes se kompresoreve
- Informacionin nese eshte duke punuar ne gjendje normale apo ne alarm
- Alarmet e ndryshme mbi punën e pajisjeve ftohëse.
- Informacioni duhet të ruhen për një periudhë kohe 3 mujore, etj.

Për secilin nga funksionet që bien në alarm, sistemi duhet të raportojë me ane te SMS, e-mail ose me thirrje me ze (voice call), sipas prioritetit të alarmit.

- **Sistemin e detektimit dhe fikjes së zjarrit**

Nga ky sistem duhet te merret informacioni mbi:

- Statusin e sistemit (ne regjim normal apo fault)
- Statusin Para-Alarm
- Statusin Alarm

- **Panelet elektrike**

Për sistemin e monitorimit të paneleve elektrikë duhet të parashikohen module për marrjen e informacionit nga panelet. Në varësi të sistemit të aplikuar duhet të parashikohen edhe kontaktet, ose portat e komunikimit. Multimetrat e instaluar në panele duhet të jenë të pajisuara me porta komunikimi modbus apo ekuivalent. Kontrolli i gjëndjes duhet të bëhet për të gjithë automatet kryesorë në secilin prej paneleve. Informacioni që duhet të merret për to është:

- Gjendja (i hapur/i mbyllur) e automateve.
- Informacion nese parametrat e furnizimit me energji elektrike jane jashte diapazonit normal
  - Detektimin e mungeses se tensionit
  - Asimetri te fazave
  - Renditje te kundert te fazave
  - Nivel i larte tensioni
  - Nivel i ulet tensioni
  - Frekuence e ndryshme nga 50 Hz
- Te gjithë parametrat e multimetrit U, I, P, S, Q, Hz cosφ etj.

Gjithashtu sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit duhet të integrojë, ruaje dhe përpunojnë gjithë informacionin që vjen nga paneli/et.
Në sistemin e monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit duhet të konfigurohet një pamje grafike e qartë me të dhëna on-line të skemës principale të furnizimit me energji elektrike.

- **Shperndaresit e energjise (PDU)**
  - Te gjithë parametrat e multimetrit tension, rryme, fuqi etj.

Gjithashtu sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit nepermjet sensoreve eshte përgjegjës per monitormin e parametrave te dhomave:

- Temperaturen
- Lageshtiren
- Prezencën e ujit

Sistemi duhet të japë historikun e alarmeve të gjithë pajisjeve të integruara, dhe krijojë raporte të ndryshme për mënyrën e funksionimit të pajisjeve. Sistemi, përvec raportimit on-line të gjithë pajisjeve të integruara, duhet të ruajë në database-in e tij gjithë informacionet e punës së tyre, për një periudhë minimalisht 3 muaj, si psh. konsumin e energjisë elektrike në dhomen e serverave, temperaturën e dhomës, lagështirën, etj.
Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit duhet të japë një paraqitje grafike on-line të gjitha pajisjeve që do të integrohen dhe monitorohen, si kondicionerët, UPS-të, sensorët e temperaturës, lagështisë, panelet elektrike, etj. Këto pajisje duhet të raportojnë me anë të ngjyrave gjëndjen e tyre. Ngjyra e gjelbër në gjëndje normale, të kuqe për avari në pajsje. Me klikim në secilën prej pajisjeve duhet të sigurohet marrja e informacioneve të detajuara për secilin nga sistemet e instaluara.

4.9. Sistemet e sigurise per dhomen e serverave

4.9.1. Sistemi i video-monitorimit (CCTV)

Dhoma e serverave duhet te pajiset me sistem video-monitorimi CCTV dhe sistem te kontrollit te aksesit. Brenda dhomes se serverave duhet te instalohen 7 kamera per vezhgimin e gjithe hapesires se dhomes.

Gjithashtu, dhoma e serverave duhet te pajiset me sistem kontrolli aksesi me dy lexues per deren e dhomes se serverave (brenda dhe jashte dhome).

Regjistrimi i kamerave në dhomen e serverave do të behet me ane të video regjistratorit te rrjetit, NVR-se lokale, ndersa kamerat do të ushqehen nëpërmjet teknologjisë PoE për të evituar instalimet e rrymës elektrike. Të gjithë aksesorët e nevojshëm për montimin e kamerave duhet të jenë të përfshira.

Dhoma e serverave eshte kerkuar te ndertohet konform standarteve kombetare dhe nderkombetare, ndaj nuk do te lejohet zgjidhje me koka RJ45, por duhet te vendosen konektore RJ45 dhe lidhja e kamerave duhet te behet me Patch Corda. Kabllot duhet te perfundojne ne Patch Panele dhe kategoria e gjithe kabllove te bakrit eshte kerkuar 6A.

Për ushqimin e kamerave me PoE duhet të instalohet nje switch sipas specifikimeve te percaktuara me poshte. Standarti qe duhet te perdoret per lidhjen e kamerave eshte me kabell Cat 6a FTP LSZH

Me poshtë janë specifikimet teknike për komponentët kryesore të sistemit te video-monitorimit CCTV.

4.9.1.1. Video Regjistrator Rrjeti – NVR – 1 copë

Pajisja e regjistrimit NVR duhet të përdoret për të regjistruar kamerat që do të instalohen në dhomen e serverave.

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Numri i kanaleve hyrëse	8 kanale ose me shume

Incoming bandwidth	Min 150 Mbps
Rezolucioni maksimal në regjistrim	Min 8 MP
Synchron Playback	min 8 kanale
Formati i Videos	H.264 ose me mire
Kapaciteti i numrit të Hard-disqeve	Min 2
Kapaciteti fizik i disqeve	Deri në 8 TB
HDD te përfshira	2 x 4TB HDD
Porta e rrjetit	Min 1 x RJ-45 10/100/1000 Mbps
Portat USB	Min. 2 x USB
Porta Video "Display Port":	Të paktën (1) HDMI dhe (1) VGA

4.9.1.2. **Kamera (Tipi Bullet) – 7 copë**

Karakteristikat	**Vlerat specifike minimale**
Tipi i kameres ("Type of camera")	Bullet
Procesori i figures ("Image Sensor")	1/3" Progressive Scan CMOS sensor
Rezolucioni i figures ("Resolution")	Minimumi 2688 × 1520
Frekuenca e kuadrove ("Frame Rate")	30 fps
Reduktimi i zhurmes ("Noise Reduction")	3D DNR
Tipi i lenteve ("Lens Type")	fikse
Gjatesia fokale ("Local length")	4 mm
Ndjeshmeria drites në 50 IRE, ("Min. Illumination @50IRE)	Color 0.001 lux; B/W 0 lux with IR
Ndriçimi Infra të Kuqe ("IR illuminators")	30 m;
Rezistenca ndaj pluhurit dhe shiut	IP67
Rezistenca ndaj vandaleve	IK10
Dite/Nate ("Day/Night")	IR cut filter
Diapazoni dinamik i djeshmerise, (Wide Dynamic range)	Po ("Yes"), min 120 dB
Formati i kompresimit të Videos	H.264 ose me mire
Dedektim i levizjes ("Motion Detection")	Po
Pajtueshmeria e sistemit ("System support")	ONVIF
Multi-streaming	Min. Dual stream
Temperatura e operimit ("Operating Temperature")	-10°C -+50°C
Ushqimi ("Power")	PoE
Aksesore per montimin	Po, sipas tipit të kameres dhe menyres se montimit

4.9.1.3. **Switch për sistemin e kamerave – 1 copë**

Switch qe duhet të përdoret për të ushqyer me PoE kamerat e instaluara per monitorimin e dhomes se serverave.

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Modeli	I montueshem ne rack, 1U, aksesore te perfshira
Nderfaqet/Portat	24 porta RJ-45 me autonegocim dhe shpejtesi 10/100/1000, PoE+ ports
Memorja	Min 32MB flash Min 128MB RAM Min 512 KB packet buffer
Kapaciteti/Performanca	Kapaciteti Switching min: 50 Gbps Aftësia perpunuese ne dalje (throughput): min. deri ne 40 Mpps Tabela e Mac-Address: Min 8000 Entries Tabela e rutimit: min 32 entries
Karakteristika L2 Switch	Të suportojë Spanning Tree Protocol (STP) Te suportoje VLAN dhe tagging Te suportoje IEEE 802.1Q; 256 VLANs me seri VLAN ID nga 2-4093
Karakteristika L3	Static IPv4 routing DHCP relay Address Resolution Protocol (ARP)
Siguria	Të suportoje Liste te avancuar kontrolli (Advanced access control lists (ACLs) Te suportojë qasjet ne rrejt nëpermjet IEEE 802.1X dhe RADIUS. Te suportoje Secure Socket Layer (SSL) Izolim portash Caktim automatic i VLAN
QoS	Kualitet sherbimi 802.1p Klasifikim i avancuar bazuar ne QoS Vendosje limiti te trafikut
Manaxhimi	WEB me SSL (HTTPS) Suport per SNMP: v1/v2c/v3 Monitorim ne distance (RMON) Suport per FTP, TFTP, ose SFTP Të suportoje sinkronizimin e ores nga nje pajisje rrjeti(Network Time Protocol (NTP) Pasqyrim te portave
PoE power	370 W PoE+
Fuqia/Ambienti	Hyrje tensioni 220v AC, 50 Hz Temprature operacionale: 0 – 40 degree Celsius Lageshtira: 15% to 90%, noncondensing

Garancia	Min 1 vit

4.9.2. Sistemi i Access Control

Zgjidhja për sistemin e akses kontrollit duhet të jete e bazuar në TCP/IP në mënyre që ti ofrohet akses të gjithë personave të cilët do të jene të autorizuar për të pare apo për të konfiguruar sistemin. Sistemi duhet të jete i afte për tu implementuar per sisteme te vogla me një dere të vetme për të monitoruar hyrje-daljet, deri në sisteme komplekse me disa dyer.

Sistemi i aksesit te kontrollit duhet te perbehet minimalisht nga elementet:

- Reader- lexuesa – 2 lexuesa duhet te instalohen ne hyrjen e ambienit te dhomes se serverave, nje ne anen e jashtme, dhe nje ne anen e brendshme, per te lejuar hyrje- daljen e stafit pergjegjes nga dhoma e serverave. Specifikimet minimale te lexuesve specifikohen ne paragrafin e meposhtem.
- Kontroller aksesi - 1 kontroller (central) duhet te instalohet ne dhomen e serverave. Centrali do te jete i lidhur me 2 lexuesat e instaluar dhe do te lejoje, bazuar ne konfigurimet e regjistruara ne te, hyrjen vetem te personave te autorizuar per te patur akses ne kete dhome. Karakteristikat minimale te kontrollerit jepen ne paragrafet e meposhtem.
- Magnet – sistemi i aksesit duhet te perfshije 1 magnet qe do te instalohet ne deren antizjarr per te mos lejuar hapjen e saj nga staf i pa pajisur me karta aksesi. Karakteristikat minimale te magnetit jepen ne paragrafin e meposhtem.
- Karta aksesi – minimalisht 10 karta aksesi per te lejuar hyrjen e stafit te autorizuar ne ambientin e dhomes se serverave.

Karakteristikat e kontrollerit (hardware)

Akses kontrolli duhet të ketë këto karakteristika të përgjithshme:

- Memorie të brëndshme për minimalisht 30,000 ngjarje
- Ushqimi: 10-30V DC dhe/ose PoE IEEE 802.3af/at
- Komunikimi TCP/IP, RS-485
- Siguria e rrjetit: Filtrim i adresave IP, enkriptim HTTPS, mbrojtje me fjalëkalim
- Temperaturat e operimit: nga 0°C to +45°C
- Të ofroje mundesinë e autentifikimit vetëm me karte, vetëm me PIN ose me karte edhe me PIN.

Akses kontrolli duhet të ofroje mundesinë e konfigurimit të pajisjes nëpërmjet ndërfaqes web. Centrali duhet të ofroje ndërrim i PIN, ndërrim i kartës, shtimi apo heqja e perdoruesve si edhe ndryshimi i skedulimeve të akseseve.

Lexuesit

- Lexuesit duhet të suportojnë karte dhe PIN

- Teknologjitë e leximit: Generic 13,56 MHz (MIFARE Classic, MIFARE Plus, vMIFARE DESFire EV1, iCLASS® CSN
- Shkalla e leximit: 30 mm
- Temperaturat e punës: nga -20 ° C në + 70 ° C
- I pajisur me tamper për të detektuar në qofte se hiqet nga muri.
- Sinjalizimin për: Akses i konfirmuar (Access Granted), Akses i refuzuar (Access Denied), armed, dissarmed

Magneti

- Deri në 300 kg e forcës mbajtëse
- E monitorueshme
- 12/24 VDC
- Status me led për gjendjen e derës

4.9.3. Switch Layer 3

Paisja duhet te kete funksionalitetet e meposhteme:
Pajisja duhet te jete e menaxhueshme dhe e instalueshme ne rack.
Pajisja te kete 48 porta fikse sfp+ 1/10 Gbps.
Pajisja te perfshije 24 module transciever 10GB sfp+ per fiber multimode me konektor duplex LC.
Pajisja duhet te ofroje kapacitet switching >= 480 GBps.
Pajisja duhet te ofroje performance >= 360 Mpps.
Pajisja duhet te ofroje >= 64,000 mac adresa.
Pajsja duhet te kete mundesi pershkallezimi gjate funksionalitetit ne layer 3 per >= 24,000 ipv4 rrugezimeve.
Pajisja te suportoje arkitekture me performance te larte per protokolle baze dhe te avancuara rutimi.
Pajisja duhet te kete kapacitet >= 4 GB per memorje dhe flash storage minimumi 4 GB.
Pajisja duhet te kete porte menaxhimi te vecante RJ45 dhe porte seriale RS232.
Pajisja duhet te kete USB per perdorim gjate permirsimit te sistemit dhe hedhjen e konfigurimeve.
Pajisja duhet te perfshije power supply AC redundante.
Pajisja duhet te kete redundance hot swappable te power supply dhe faneve.
Pajisja duhet te kete LED per te shfaqur statusin e cdo funksioni bazik si: aktivitetin e lidhjes, shpejtesine e portes, llojin e portes nese eshte duplekese, tregues nese sistemi eshte aktiv.

Paisja duhet te plotesoje standartet e meposhtme:

- IEEE 802.3z,
- IEEE 802.1D,
- IEEE 802.1Q,
- IEEE 802.3ab,
- IEEE 802.1p,
- IEEE 802.1x,
- IEEE 802.3ae,

- IEEE 802.3ad
- IEEE 802.1w,
- IEEE 802.1ax,
- IEEE 802.1s,
- IEEE 802.3ab,
- IEEE 802.1ab
- CISPR 22 Class A,
- VCCI Class A,
- EN55024,
- RoHS
- IEC 60950-1,
- EN 60950-1,
- UL 60950-1,
- CSA C22.2 No. 60950-1,
- FCC Part 15 Class A

Software i pajisjes Switch layer 3:

Sistemi operativ te jete modular, qendrueshmeri operative dhe sherbime inovative bazuar ne standarte per mission - critical te mjediseve te data-center.
Sistemi operativ te siguroje nje sere karakteristikash plotesisht te perpuethshme per nevojat e pajisjeve te data-center si switch, storage, servera.
Sistemi operative te siguroje funksionim te vazhdueshem gjate mirmbajtjes, permirsimit apo certifikim te software pa nderprerje te sherbimit.

Software duhet te kete keto karakteristika:

- Layer 2 switch port
- Layer 3 switch port
- VLAN trunking,
- Te suportoje >= 4096 VLAN
- Link Aggregation Control Protocol
- Jumbo frame: 9216 byte
- Akses lista: 4096
- Inter-VLAN Routing
- Protokoll per eleminimin e lupave ne switch.
- Static routes, (RIPv2), ACL, OSPFv2,
- Virtual Router Redundancy Protocol,
- Storm control (multicast, broadcast)
- Multicast(PIM-SM), Source-Specific Multicast, dhe Multicast Source Discovery Protocol
- Security: Authentication, Authorization, and Accounting (AAA)
- Protokolle per autentikimin dhe menaxhimin ne distance:SNMPv 1,2,3: RMON I,II,:ftp: http,https, ssh, telnet, RADIUS, TACACS.

Software duhet te ofroje karakteristika per monitorim dhe analizmin e trafikut ne portat e switchit.
Sistemi duhet te monitoroje te kontrolloje lidhjet midis dy nderfaqeve, te monitoroje utilizimin e trafikut dhe performancen midis portave te switche-ve apo vlan-ve.
Pajisja te kete te perfshire license te perhershme per 24 porta ne menyre qe ato te operojne per trasmetim 1/10 Gbps.
Garancia per support duhet te ofrohet nga prodhuesi ose partneri i autorizuar per sherbime nga prodhuesi per nje periudhe 1 vjecare.

4.9.4. Server

1. *Modeli i Serverit:*

- Serveri duhet te jete i instalueshem ne rack dhe lartesia e tij nuk duhet te jete me shume se 4 HU.
- Serveri duhet te suportoje minimumi 8 hard drive.
- Serveri duhet te kete te perfshire kit per instalimin ne rack.
- Serveri te kete te perfshira cdo kabell per vendosjen e tij ne gjendje pune.
- Serveri te suportoje hot plug redundante te sistemit ftohes (fan-ve).
- Serveri duhet te kete te perfshire dy burime ushqimi.

2. *Modeli i procesorit:*

- **Serveri duhet te suportoje kater procesore me konfigurim Intel Xeon scalable (“Skylake-SP”) (ose ekuivalent).**
- **Serveri duhet te perfshije kater (4) procesore.**
- **Serveri te kete te perfshire kater procesore me te pakten 18 core secili dhe cache jo me te vogel se 24 Mb.**

3. *Memorja Ram:*

- **Serveri duhet te kete minimumi 768 GB kapacitet RAM.**
- **Serveri te suportoje deri ne 12 module Ram per cdo procesor.**
- **Te suportoje karakteristikat e meposhte :**
  - **Performace Optimized,**
  - **Single, multi data device correction,**
  - **Online Memory sparing,**
  - **Memory mirroring,**

4. *Kontrolleri RAID:*

- **Serveri duhet te kete kontroller fizik me nderfaqe jo me pak se SAS 3.0 me shpejtesi 12 Gbps dhe memorje cache 2 GB**
- **Severi te kete te perfshire jo me pak se dy (2) hard drive me kapacitet 400 GB.**
- **Serveri duhet te suportoje controller RAID me nderfaqe 12Gbps me nivele RAID: 0, 1, 5, 10, 50, 60**

5. *Nderfaqet:*

- **Serveri duhet te kete te perfshire minimalisht 4 porta sfp+ gigabit ethernet me module transciver te perfshire per fiber multimode.**
- **Serveri duhet te kete te perfshire te pakten nje karte fiber me dy porta minimalisht 16 Gb/sec me module transciver te perfshire per fiber multimode.**

6. *Menaxhimi:*

- **Serveri duhet te kete software per kontroll dhe monitorim ne largesi duke ofruar funksionalitetet e meposhteme:**
- Console menaxhimi ne largesi per te aksesuar pajisjen nepermjet web browser.
- Te informoje ne menyre automatike me email administratorin per cdo defekt qe mund te ndodhe si: keqfunksionim i drive-e, moduleve te memorjes, power supply, faneve dhe procesoreve.
- Te kete mundesi rindezje, fikje dhe ndezje ne largesi te pajisjes (perfshire dhe boot-im nga drive-e virtuale).
- Konsola virtuale duhet te suportoje funksionalitet gjate perdorimit te web browser.
- Mundesi te mbledhe informacion rreth nivelit te perdorimit te CPU dhe memorjes RAM te serverit pa nevojen e instalimit te agjenteve ne systemin e operimit.
- Mundesi per te menaxhuar kontrollerat e instaluar ne brendesi te shasise se pajisjes nepermjet nderfaqes web ose nderfaqes se kontrollerit pa nevojen e instalimit te agjenteve software te sistemit te operimit.
- Mundesi shfaqje nepermjet nderfaqes web ose cli per te eksportuar informacion per diagnostifikimin e statusit te pajisjes.
- Te suportoje shkrimin e konfigurimeve te moduleve te kontrollit ne nje drive te dedikuar i instaluar ne brendesi te pajisjes, per te rivendosur statusin e serverit ne rastin e nderrimit te bordit,
- Mundesi per te perdoruar hardware dhe software per pergatitje te instalimit te sitemit operativ (konfigurim te volumeve, krijimin e particioneve, kopjimin e drive-e, krijimin e file per pergjigje gjate instalimit te sistemit operativ) te cilat nuk kerkojne perdorimin e hapesirave media te jashtme.
- Mundesi per te kryer perditsim te mikrokodeve te komponenteve te pajisjeve ndepermjet nje moduli nderfaqe menaxhimi dhe perditsim te sistemeve operative te suportuar.
- Paisjet duhet te jene të reja, të papërdorura, të përfshijnë të gjitha përmirësimet e fundit në dizajn dhe materiale dhe nuk janë deklaruar nga prodhuesi si end of sale ose end of availability .

7. *Garancia*

Duhet te ofrohet garanci nga prodhuesi per nje periudhe minimumi 3 vjecare per hardware dhe software.

Shtojca11

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

☐ Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	**Titulli i Kontratës**	**Përshkrim i shkurtër i kontratës**
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
…	_____	_____

Shtojca 12

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi/Njesi	Vlera
1	Punime civile jo te specializuara	set	1		
2	FV. Dere zjarrduruese	copë	1		
3	F.V. Rack 42U 800 mm x 1200 mm me aksesoret perkates	cope	6		
4	FV. Dysheme teknologjike	m2	42		
5	FV. Panelet Elektrike te kompletuar me te gjithe aksesoret per montim	set	2		
6	Instalime elektrike ne dhomen e serverave të qendrës së vazhdueshmërisë së biznesit (BCC Site) (perfshi ndricuesit linear, ndricues emergjence dhe aksesoret perkates, kanalinat dhe kabllot, tokezim etj.)	set	1		
7	FV. Sistem UPS 40 kVA	copë	2		
8	F.V. Shpërndarësit e energjisë (PDU) 32A	copë	12		
9	FV. Sistem Kondicionimi rreth 34 kW	set	2		
10	FV. Rrjet të transmetimit të të dhënave (Network Pasiv) (perfshi kabllim i paraterminuar Bakri dhe Fiber Multimode OM4, Patch Panele, Patch Guide, aksesore etj.)	set	1		
11	FV. Sistem i video-monitorimit (7 Kamera, NVR dhe switch me PoE)	set	1		
12	FV. Sistem Access Control per deren (Kontrolleri, lexuesit, magneti)	set	1		
13	F.V. Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit (përfshi ndërfaqen e komunikimit me UPS, me sistemin e kondicionimit, me sistemin e dedektimit dhe fikjes së zjarrit, me	set	1		

	panelet elektrike dhe me shpërndarësit e energjisë në Rack-e (PDU-të) dhe parametrat e ambjentit				
14	F. V. Sistem i detektimit dhe fikjes se zjarrit (përfshi panelin e kontrollit, detektorët e tymit dhe të temperatures, sirenat, cilindrin me agjentin e shuarjes, pajisjet e sinjalizimit (Alarmit), butonat e aktivizimit dhe ndalimit manual, tubat dhe nozolat e shkarkimit, Valvulat e shkarkimit, sprucatorët etj.	set	1		
15	Switch Layer 3	cope	2		
16	Server	cope	2		

Afatet e lëvrimit: 180 dite nga nenshkrimi i kontrates

Shtojca 13

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR[4]

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik".

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.
Me respekt
< Emri >

[4] Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 14

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

* * *

Procedura e prokurimit:
Numri i referencës së procedurës/lotit:
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët □ oferta ekonomikisht më e favorshme □
Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1._____ _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2._____ _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)
Etj._____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1._____ _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
2._____ _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

_____
_____
_____

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo_____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: *[Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]*

1._____

2. _____

*3.*_____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: □ oferta ekonomikisht më e favorshme □çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1._____ _____

Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2._____ _____

Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1._____ _____

Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
2._____ _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:
_____
_____
_____

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:
1._____ _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/ Pikët totale të marra ____
(me numra dhe fjalë)
2._____ _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra ____
(me numra dhe fjalë)
Etj.__

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]*, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo_____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME
Mallrat – Tender i Hapur

Neni 1: Qellimi

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruara me anë të procedurës me negociim.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.

2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.

2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.

2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.

2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

4.1 Atoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjeter që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.

7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

8.2 Mallrat nuk janë në perputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin per te cilin sherbejne zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.

8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.

9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.

9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.

9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilesinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës se shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.

10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.

10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.

10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.

10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazhuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës

12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.

12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimit.

12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

12.5 Ekzekutimi i testeve, apo inspektimi i Mallrave nuk e shkarkojnë Kontraktuesin nga garancitë apo detyrimet e tjera sipas kontratës.

Neni 13: Kushtet e Dorëzimit

13.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit përveçse kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

13.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.

13.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve të lidhura me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.

13.4 Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim të rastit kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozitë të kontratës.

13.5 Kontraktuesi është i detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një periudhe kohore të arsyeshme për dorëzimin e Mallrave përpara arritjes së tyre.

Neni 14 Transportimi i Mallrave

14.1 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin e Mallrave siç kërkohet, me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuara në kontratë.

14.2 NëAurtoriteti Kontraktor është i detyruar të marrë Mallrat nga ndonjë mjet transporti apo agjenci transporti, Kontraktuesi duhet të japë lajmërim paraprak të arsyeshëm për transportin dhe t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave.

14.3 Nëse shitësi, [Kontraktuesi] është i detyruar t'i dorëzojë mallrat në mjetin e transportit në një vend të specifikuar në kontratë, risku i humbjes kalon tek Autoriteti Kontraktor vetëm kur mallrat i dorëzohen mjetit të transportit në vendin e specifikuar. Fakti se shitësi [Kontraktuesi] është i autorizuar të mbajë dokumentat përfaqësuese të mallrave nuk influencon në kalimin e rriskut.

Neni 15: Siguracioni

15.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi duhet të sigurojë qëe Mallrat që do të dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit gjatë transportit, magazinimit ose dorëzimit të tyre.

Neni 16: Verifikimi dhe Pranimi i Mallrave

16.1 Përpara pranimit, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të verifikojë, inspektojë dhe testojë Mallrat. Këto veprime duhet të kryhen menjëherë pas dorëzimit të Mallrave. Kontraktuesi ka të drejtë të marrë pjesë në këtë proces dhe të shqyrtojë raportet përkatëse të prërgatitura nga Autoriteti Kontraktor ose agjentët e tij.

16.2 Autoriteti Kontraktor pranon ose refuzon Mallrat menjëherë pas dorëzimit duke njoftuar me shkrim Kontraktuesin në lidhje me vendimin e tij për të pranuar ose refuzuar Mallrat.

Neni 17: Garancitë

17.1 Kontraktuesi garanton se Mallrat janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se ato trupëzojnë përmirësimet e fundit në skicim dhe materiale, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë.

17.2 Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për çdo defekt ose mospërputhje që ekziston në momentin kur risku kalon tek Autoriteti Kontraktor, edhe kur defekti shfaqet pas këtij momenti.

17.3 Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për mospëputhjen që verifikohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm dhe që vjen nga mospërmbushja e ndonjë detyrimi, duke përfshirë garancinë që Mallrat duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e tyre të zakonshëm dhe specifik për një periudhë të caktuar kohe, ose se ato do të ruajnë cilësitë dhe karakteristikat e caktuara.

17.4 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë ose në ligj, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën e tij për të kundërshtuar lidhur me të metat e sendit nëse ai nuk i denoncon ato të shitësi (Kontraktuesi), duke specifikuar natyrën e tyre, brenda dhjetë ditëve nga zbulimi i tyre.

17.5 Autoriteti Kontraktor s i mundëson Kontraktuesit të gjitha mjetet e nevojshme për të inspektuar këto defekte.

17.6 Pas marrjes së këtij njoftimi, Kontraktuesi duhet të riparojë menjëherë ose të zëvendësojë Mallrat defektoze ose pjesët e tyre pa pagesë shtesë për Autoritetin Kontraktor.

17.7 Nëse pas marrjes së njoftimit, Kontraktuesi dështon në rregullimin e defektit brenda një periudhe të arsyeshme, Autoriteti Kontraktor mund të ndërmarrë veprime për rregullimin e nevojshëm, me shpenzimet e Kontraktuesit.

17.8 Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit nëse ai nuk e ushtron të drejtën e tij brenda dy vjetësh nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po qe se ky afat nuk bie në kundërshtim me kohëzgjatjen e garancisë kontraktore.

17.9 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mund të shfrytëzojë rregullat e parashikuara ketu nëse defektet kanë të bëjnë me fakte të njohura prej tij ose që nuk mund të ishin të panjohura për të dhe që nuk i janë vënë në dukje Autoritetit Kontraktor.

Neni 18: Çmimi i Kontratës

18.1 Çmimi i kontratës është çmimi i dhënë në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktor.

18.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, çmimi i kontratës përfshin kostot dhe tarifat, duke përfshirë taksat dhe tarifat doganore të lidhura me dorëzimin e Mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, instalimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualet dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar dhe të nevojshme për përdorim të rrëgullt, mirëmbajtje dhe riparime të Mallrave. Vlera e taksave dhe tarifave duhet të përcaktohet sipas legjislacionit përkatës, në fuqi 28 ditë para hapjes së ofertave.

Neni 19: Afatet e Pagesës

19.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.

19.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise i fiksuar në ditën e dërgimit për botim të njoftimit të kontratës.

19.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoritetit Kontraktor me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan Mallrat e dorëzuara dhe shërbimet e kryera.

19.4 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa për Mallrat do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë pranuar Mallrat ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë.

19.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 20: Vonesa në Bërjen e Pagesës

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

Neni 21: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

21.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 22: Forca Madhore

22.1 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i verifikimit te rasteve të Forcës Madhore.

22.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme nga ana e tij. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

22.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 23: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

23.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

23.2 Me përjashtim të rasteve kur Autoriteti Kontraktor është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së zbatimit të specifikuar në kontratë.

23.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë Kontraktuesinme shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

23.4 Autoriteti Kontraktor pranon zgjatjen e afatit në rastin e Forcës Madhore.

23.5 Autoriteti Kontraktor mund pranojë zgjatjen e afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë me përpikmëri Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore::

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet

25.1 Palët nuk mund të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet bazë për përzgjedhjen e Kontraktuesit.

25.2 Asnjë amendament ose ndryshim tjetër i kontratës nuk është i vlefshëm nëse ai nuk bëhet me shkrim apo nuk ka një datë të përcaktuar, si edhe nëse ai nuk i referohet shprehimisht kontratës apo nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoriteti Kontraktor.

25.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 26: Ndryshimi i Porosisë

26.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Mallra ose Shërbime shtesë deri në një masë që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente më rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Neni 27: Ndërprerja për Mosplotësim

27.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

a) Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

27.2 Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë me shkrim Kontraktuesin për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japë Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 28: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

28.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

28.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 29: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

29.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

29.2 Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë me shkrim Kontraktuesin për ndërprerjen..

29.3 Autoriteti kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Mallrat e pranuara dhe Shërbimet e lidhura me to të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Shërbimeve të lidhura me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 30: Nënkontraktimi

30.1.Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

30.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nën kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

30.3 Çdo nënkontraktor ka të drejtë të marrë pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për mallrat që do të furnizojë.

30.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 31: Transferimi i të **Drejtave**

31.1 Kontraktuesi nuk mund të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

Neni 32: Sigurimi i Kontratës

32.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

32.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

32.3 Garancia e sigurimit të kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së pranimit të Mallrave. Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontratës.

Neni 33: Baza Ligjore

33.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 34: Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

34.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarërveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

34.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 35: Përfaqësimi i Palëve

35.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

35.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

35.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta, rast në të cilin njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 36: Lajmërimet

36.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

36.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 37: Llogaritja e Afateve

37.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.

Shtojca 17

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

KUSHTET E VEÇANTA
Mallrat – Procedurë e Hapur

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës.

Neni 1: Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është

1.2 Kontraktuesi është

Neni 2: Sigurimi i Kontrates

2.1 Sigurimi i Kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:

Neni 3: Fillimi i Zbatimit

3.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojëe më _____. Nëse data nuk është e përcaktuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

Neni 4: Inspektimet dhe Testimet

4.1 Inspektimet dhe testimet para pranimit të Mallrave do të bëhen:

Neni 5: Kushtet e Dorëzimit

5.1 Data (t) dhe vendi (et) i dorëzimit të Mallrave do të bëhet sipas Grafikut të Lëvrimit të parashikuar në këtë kontratë.

5.2 Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor_____ ditë para çdo dorëzimi të Mallrave.

5.3 Lajmërimi i dorëzimit duhet të bëhet me shkrim, faks, postë, e-mail etj, tek:

5.4 Nëse Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga një palë e tretë, lajmërimi i dorëzimit duhet të përfshijë listën e dokumentave të nevojshme për marrjen e Mallrave dhe të tregojë se ku dhe kur do t'i jepen dokumentat Autoriteti Kontraktor.

5.5 Nëse Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga një palë e tretë, Kontraktuesi duhet të dorëzojë të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave tek:

Neni 6: Kushtet e Pagesës

6.1 Pagesa e Mallrave duhet bërë brenda 180 ditëve nga data e pranimit të Mallrave ose nga data e marrjes se kerkeses me shkrim te pagesës, sado vone qe te vije. Nëse nuk është specifikuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

6.2 Monedha e pagesës do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 7. Pagesa Paraprake

7.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë 0 (zero). Nëse nuk është specifikuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

7.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda _____ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

7.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme:

Neni 8. Shërbimet në Lidhje me to

8.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura

Neni 9. Zbritja e garancisë së kontratës

9.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë _____

_____

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

Shtojca 18

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR

Seksioni 1 **Autoriteti Kontraktor**

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____

Adresa _____

Tel/Fax _____

E-mail _____

Faqja në Internet _____

I.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion Qëndror	Institucion i Pavarur
☐	☐
Njesi e Qeverisjes Vendore	Tjetër
☐	☐

Seksioni 2. Objekti i Kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit_____

2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Mallra"

Blerje	Qira	Leasing	Blerje me këste	Një kombinim i tyre
☐	☐	☐	☐	☐

2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po ☐ Jo ☐

Nëse Po, lloji i Marreveshjes Kuadër

Me 1 Operator Ekonomik ☐

Me disa operatorë ekonomikë ☐

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po □ Jo □

2.4 Përshkrim i shkurtër i kontratës

1 Fondi limit _____

2. Burimi i Financimit _____

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër_____

2. 5 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në **muaj** □□□ **ose ditë** □□□□

ose

duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

2.6 Ndarja në LOTE:

Po □ Jo □

Nëse Po, numri i LOTEVE*:* □□

2.7 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka): □□

ose: nga □□ në □□ □□□

2.8 Kontrate me nenkontraktim:

Po □ Jo □

Seksioni 3. <u>Procedura</u>

3.1 Lloji i procedurës: E Hapur

3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **çmimi më i ulët** □

ose

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme** □

lidhur me rëndësinë: Çmimi □□ **pikë**□

etj. □□ **pikë**

3.3 Numri i ofertave të dorëzuara: □□□

Numri i ofertave të rregullta: □□□

3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushen e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombetare e Shoqërise së Informacionit:

Po □ Jo □

3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të paaplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit

Po □ Jo □

Seksioni 4 <u>Informacion mbi kontratën</u>

4.1 Numri i Kontratës: _____Data e Kontratës □□/□□/□□□□

4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit

Emri _____

Adresa _____

Tel/Fax _____

E-mail _____

Faqja e Internetit _____

4.2.1 **Emri dhe adresa e nenkontraktorit/eve**

Emri _____

Adresa _____

Tel/Fax _____

E-mail _____

Faqja e Internetit _____

4.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës *(duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin)*:

Vlera _____ *(pa TVSH)* Monedha _____

Vlera _____ *(me TVSH)* Monedha _____

4.3.1 Vlera totale **e nenkontraktimit : ____**

Vlera _____ *(pa TVSH)* Monedha _____

Vlera _____ *(me TVSH)* Monedha _____

4.4 Informacione shtesë

<u>Për nënshkrimin e kontratës publike, në përfundim të proçedurës, operatori ekonomik duhet të kenë:</u>

Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të Faturave.

Kopje të Certifikatës elektronike per Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar që zgjidhjen softwere-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softwar-ike".

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi □□/□□/□□□□

Shtojca 18/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____

Adresa _____

Tel/Fax _____

E-mail _____

Faqja në Internet _____

2. Lloji i procedurës: _____

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër_____

4.Numri i referencës së procedurës/lotit_____

5. Fondi limit _____

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës *(duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin)*:

Vlera _____ *(me TVSH)* Monedha _____

Vlera e nenkontraktimit_____*me Tvsh* Monedha _____

7. Data e lidhjes së kontratës _____

7. Emri dhe adresa e kontraktorit /nenkontraktorit

Emri _____

Adresa _____

Nr. NIPT _____

Shtojca 19

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

[Data]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

Shtojca 20

FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ankesë drejtuar: ***Autoriteti Kontraktor*** ☐

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërish).

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

Qyteti | Shteti | Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) | Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës) | Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Seksioni II. Informacion për Procedurën

1. Numër Identifikimi

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë ***llojin e procedurës së përdorur*** *për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).*

_____

2. Autoriteti Kontraktor

Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

_____

3. Vlera e Përllogaritur e Prokurimit

Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

_____

4. Objekti i Kontratës

Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.

_____

5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

_____

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese

_____

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore e Ankesës

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

_____

2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

3. Lista e Shtojcave

Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht ***çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj .*** *Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

Nr. Faks:
E-mail:

Nënshkrimi dhe Vula e ankuesit

Shtojca 21

DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR
(KU TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)
PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME

[Përdorimi i ketij draft marrëveshje është detyruese për të gjitha Autoritetet Kontraktore që do të përdorin marrëveshjen kuadër)

Nr __

DATA:

Kjo kontratë lidhet më [*data*], midis [*emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor*] tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe [*emri dhe adresa e Kontraktuesit*] të përfaqësuar nga [*përfaqësuesi*], tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [*data*] bie dakord të furnizojë mallrat, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë kontrate
- Formularin e Deklarimit të Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formularin e çmimit të ofertës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate.

Neni 1 Objekti

1.1 Objekti i marreveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat për dorëzimin e mallrave/sherbimeve/puneve në vijim.

[përshkrimi i përgjithshëm]

1.2 Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marrëveshje. P.sh. kurdoherë që Autoriteti Kontraktor i përfshirë në këtë marreveshje, do të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate, duhet që të dërgojë "ftesën për ofertë" tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e parashikuara, janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato te parashikuara.

1.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër:

_____

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimet për njësi për punë/mallra /shërbime janë treguar në Formularin e Cmimit të Ofertës.

2.2 Çmimet e njësive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.

Nënshkrimet dhe Datat

Për Kontraktuesin		**Për Autoritetin Kontraktues**	
Emri:		**Emri:**	
Pozita:		Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		**Vula:**	

Shtojca 22

DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR

(KU JO TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)
PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME

Emri i Autoritetit Kontraktues,

Dhe

Emri i Kontraktuesit

Bien dakord si vijon:

Të nënshkruajnë këtë Marrëveshje kuadër për objektin : < vendosni titullin > me numrin identifikues : *<vendosni Numrin e Prokurimit>*

Neni 1 Objekti

1.1 Objekti i kësaj marreveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes procesit të mini-konkursit vetëm ndërmjet operatorëve ekonomike që janë palë e kësaj marrëveshje kuadër.

1.2 Kjo marrëveshje kuadër nuk është një kontratë në vete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen në bazë të saj.

1.3 Kontraktuesi është vetëm një nga palët e marrëveshjes kuadër.

Neni 2 Detyrimet e Palëve

2.1 Autoriteti Kontraktues, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë kontraktuesit "Ftesën për Oferte" kurdo që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime.

2.2 Kontraktuesi, detyrohet të dorëzojë një ofertë kurdo që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 3 Kontratat në zbatim të marrëveshjes kuadër

3.1 Kontratat do të nenshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkursit.

Neni 4 Procesi i mini-konkurrencës

4.1 Procesi i mini- konkursit do të kryhet me të gjithe operatoret ekonomike, palë në marrëveshjen kuadër, kurdoherë që paraqitet nevoja për punë /mallra/shërbime për Autoritetet Kontraktore.

4.2 Autoriteti Kontraktor do të ri-hapë konkursin në bazë të kushteve të njëjta ose të kushteve të tjera të vendosura në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit.

4.3 Kurdoherë që paraqitet nevoja për punë/mall /shërbim Autoriteti Kontraktor duhet të përgatisë Ftesat për Oferte dhe t'ua dërgojë të gjithë operatorëve ekonomike, palë në marrëveshjen kuadër. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.

Neni 5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër

_____

Nënshkrimet dhe datat

PërKontraktuesin		**Për Autoritetin Kontraktues**	
Emri :		**Emri:**	
Pozita:		Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		**Vula:**	

Shtojca 23

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE ANULIMIT

1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____

Adresa _____

Tel/Fax _____

E-mail _____

Faqja në Internet _____

1. Lloji i procedurës: _____

2. Numri i Referencës: _____

3. Objekti i kontratës _____

4. Fondi limit _____

5. Arsyet e Anulimit:

Bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 24, pika 1:

a) ;
b) ;
c) ;
ç) ;
d) ;
dh) ;
Etj. _____

6. Informacione shtesë

_____

_____

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi.